

Fjalat e Paqes

*Atëherë Jezusi tha:
O djall,
sepse Shkrimi i shenjtë thotë:
Adhuroje Zotin,
Hyjin tënd, dhe shërbeji
vetëm Atij!
Mt 4, 10*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult **Nr. 3 (146) Viti XXI Prill - Tetor 2019**

DEKLARATË E KONFERENCËS IPESHKVORE TË SHQIPËRISË PËR SITUATËN AKTUALE NË VENDIN TONË

Të mbledhur në Asamblenë e Përgjithshme të Zakonshme të Pesëdhjetepestë të Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë në datat 13-14 maj e duke ndjekur me shqetësim e keqardhje të madhe situatën aktuale që po kalon vendi ynë, ne ipeshkvijtë katolikë të Shqipërisë deklarojmë sa më poshtë:

U bëjmë thirrje të gjithë liderëve politikë në Shqipëri, në mënyrë të veçantë liderëve të dy partive të mëdha: Kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të opozitës Lulzim Basha, që të ulin armët e konfliktit, sikurse janë gjuha urrejtjes dhe arroganca, e të gjejnë me patjetër rrugën e dialogut. Të nxiten me këmbëngulje qytetarët që të heqin dorë nga çdo formë dhune dhe vandalizmi. Kush përdor dhunë dhe vandalizëm nuk e do atdheun! Në këtë situatë, ne, me vendosmëri i themi JO DHUNËS, qoftë kur vjen nga protestuesit e qoftë kur është shprehje arbitrare e institucioneve.

Fatkeqësisht kjo ka ndodhur në mënyrë të përsëritur kohët e fundit. Por, ç'është më e keqja, askush nuk kujtohet që, qoftë protestuesit e qoftë punonjësit e policisë janë njerëz, etër, bij e pjesë e familjeve të thjeshta shqiptare.

Ne, duke u bazuar në doktrinën shoqërore të Kishës dhe në traditën e Kishës Katolike në Shqipëri, do të jemi gjithmonë në anën e njerëzve të thjeshtë dhe të jetës së përditshme që duan të jetojnë të qetë, të çliruar nga sundimi i dhunës, i korrupsionit, i kriminalitetit, i papunësisë e i detyrimit të largimit nga vendi për kushte më të mira. Këto janë problemet e mëdha që pozita dhe opozita duhet të diskutojnë së bashku për të gjetur zgjidhjet e duhura duke kërkuar të mirën e përbashkët që ka përparësi mbi të mirën e partisë.

Ne jemi dhe do të jemi për një Shqipëri demokratike, ku

institucionet respektohen dhe ku institucionet e njerëzve që i kryesojnë ato, respektojnë popullin e ligjet dhe punojnë për të gjithë e jo vetëm për pak njerëz.

Ne jemi dhe do të jemi për respektimin e parimeve të demokracisë dhe lirinë e popullit që të zgjedhë përfaqësuesit e tij dhe këta të fundit të punojnë për të mirën e të gjithëve.

Ne nuk jemi për asnjë parti politike dhe nuk mbajmë anën e askujt, por jemi të gatshëm të punojmë me gjithkënd në të mirë të vendit dhe të popullit tonë, në respekt të parimeve shpirtërore, kushtetuese dhe ligjore.

Në situatën aktuale nuk ka kohë më për të humbur, sidomos për zbatimin e reformës në drejtësi dhe për afrimin e vendit me Bashkimin Evropian.

Të mendojmë për të rinjtë tanë dhe të punojmë për përfshirjen dhe punësimin e tyre në bazë të meritave, pa humbur kohë. T'i japim hov fuqisë shndërruese që ka energjia e tyre rinore. Mos t'ua prishim ëndrrat. Mos ta çojmë vendin drejt vetëvrasjes, por drejt rritjes dhe promovimit të së mirës dhe të së bukurës.

Përsërisim bashkë me partnerët tanë evropianë se është koha e duhur që t'i dërgojmë botës një mesazh të qartë se Shqipëria dhe ne shqiptarët jemi të aftë për t'i zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore dhe demokratike.

Ne jemi lutur e do të vazhdojmë të lutemi për vendin tonë, për familjet, për të rinjtë e të rejtat dhe për ata që kanë përgjegjësi politike, që Hyji i Mirë t'ua shndrisë mendjen e të gjejnë rrugën e dialogut e të mirëkuptimit.

Tiranë, 14 maj 2019, Festa e Shën Matisë, apostull.



HOMELIA

ME RASTIN E MESHËS KRIZMALE 2019

Shumë të dashur meshtarë, vëllezër e motra të kësaj Kishe të shenjtë në Arqidioqezën Shkodër-Pult, qoftë bekuar Zoti që ka themeluar një mbretëri me ne dhe që na ka bërë meshtarë për Hyjin dhe Atin e vet. Atij i qoftë lavdia dhe fuqia në shekuj të shekujve. Amen.

“Kjo Meshë që ipeshkvi bashkëkremton me meshtarët e vet dhe në të cilën shugurohet krizma e shenjtë dhe bekohen vajërat e tjerë është shprehje e bashkësisë së meshtarëve me ipeshkvin e tyre (Cerimoniali i Ipeshkvijve).

Është e rëndësishme që krejt populli i Hyjit, në larmishmërinë e gjymtyrëve të veta, të jetë i pranishëm në këtë Meshë, me qëllim që më dukshëm të shfaqet bukuria e një Kishe krejt mbarështuese, e cila gjallërohet prej veprimit shenjtërues të Shpirtit Shenjt, që, sot, është protagonist i këtij veprimi solemn liturgjik.

Së bashku, ipeshkëv dhe meshtarë, do të thërrasim fuqinë e Shpirtit Shenjt mbi Krizmën dhe Vajërat e tjerë, pasi do të jenë këta meshtarë që do të japin sakramentet e shpëtimit duke shenjtëruar në këtë mënyrë popullin e shenjtë të Hyjit.

Cerimoniali i Ipeshkvijve vazhdon: “Për këtë Meshë mblidhen dhe bashkëkremtojnë në të meshtarët, prej momentit që për shkak të krizmës janë dëshmitarë dhe bashkëveprues të ipeshkvit të tyre, në funksionin e shenjtë të ndërtimit, të shenjtërimit dhe të udhëheqjes së popullit të Hyjit të të cilit janë pjesëmarrës dhe kështu shfaqet qartësisht njësia e meshtarisë dhe e flisë vazhdimisht të pranishme në Kishën e Krishtit”.

Ky pohim nuk është pa vlerë dhe, si i tillë, duhet të rikujtohet shpesh prej nesh, në mënyrë që të gjitha zgjedhjet tona baritore të mos jetë thjeshtë nismë e një individi – meshtar, i kushtuar apo laik – por shprehje e bashkësisë së vërtetë kishtare.

«Sot shkoi në vend kjo pjesë e Shkrimit shenjt që e dëgjuat me veshë tuaj» (Lk 4,21), thotë Jezusi në Sinagogën e Nazaretit: një vetëdije e qartë e realizimit, në personin e tij, të profecisë së Isaisë, që kemi dëgjuar edhe ne në leximin e parë: “Shpirti i Zotit Hyj është mbi mua” (Is 61,1). Një vetëdije që, si popull i shenjtë i Hyjit, i mbushur plot karizma dhe mbarështime, duhet të kemi edhe ne.

Në bazë të Pagëzimit, keto detyrat e Krishtit, për veprim të Shpirtit Shenjt, janë bërë edhe detyret tona: “Ai më dërgoi t’u kumtoj të vobektëve Ungjillin, t’u shpall robërve çlirimin, të verbërve dritën e syve; t’i lëshoj në liri të ndrydhurit, të shpall vitin e hirit të Zotit” (Lk 4,18). Bëhet fjalë për një mbarështim mëshire që përkon me objektivin parësor të ungjillëzimit: t’u kumtojë të gjithëve lajmin e mirë që Hyji, në Jezusin, ka dashur ta shpëtojë botën prej dënimit, pasojë e mëkatit të lashtë të prindërve tanë të parë.

Kjo shpjegon pse ky kremtim bie afër Pashkës; ka një lidhje të fortë me ngjarjet e shpëtimit që, duke filluar prej sonete, do të kujtojmë me një kremtim të madh që do të fillojë me Meshën e Darkës së Zotit, do të vazhdojë me Përkujtimin e Mundimeve nesër dhe do të përfundojë me Vigjiljen solemne të Pashkës pasnesër. Do të jetë një thirrje e madhe e Popullit të Hyjit ku askush nuk mund të mungojë: një asamble e përhershme, që do të na shohë duke përkujtuar jo vetëm Mundimet, Vdekjen dhe Ngjalljen e Jezusit, por edhe frytet që ky veprim shpërblyes ka sjellë në jetën tonë personale dhe bashkësiore.

Për këtë arsye ju ftoj të gjithëve ju meshtarë, që keni rol udhëheqës në bashkësitë famullitare, që ta sensibilizoni sonete popullin e Hyjit me qëllim që ai ta jetojë krejt këtë Triditësh pashkor; po ashtu, shpjegojuani mirë e me kujdes që Misteri pashkor nuk përfundon ditën e Pashkës, por lakohet në tre aspektet e Mundimeve, të

Vdekjes dhe të Ngjalljes; dhe për këtë arsye PASHKA është tërësia e pandashme e këtyre momenteve që nuk mund të ndahen prej njëri-tjetrit.

Unë dhe secili prej jush, të dashur meshtarë dhe të gjithë ju besimtarë, duhet ta pyesim veten përpara çdo veprimi liturgjik të këtyre ditëve: çfarë fryti shpëtimi më ka dhënë shpërblimi i Krishtit? Përgjigja e kësaj pyetjeje do të jetë thelbësore për të na forcuar në fe dhe do ta qartësojë gjithnjë e më shumë përkatësinë tonë ndaj Krishtit dhe Kishës. Pastaj, duke u nisur prej kësaj vetëdijeje, të gjitha veprimet tona kishtare do të marrin një kuptim dhe një domethënie të re.

Ngjarja pashkore sjell ngjallje, që do të thotë “të ngrihemi”, të braktisim palëvizshmërinë e vdekjes për t’u vënë në lëvizje: populli ynë nuk ka më nevojë të dijë që është i krishterë katolik (ai tashmë e di një gjë të tillë), por ka nevojë që të jetojë si i krishterë katolik, sipas një të vepruari ungjillor, që vetëm bashkëngjitja me Krishtin mund të ofrojë. Besimtarët tanë kanë nevojë të dinë

edhe që sakramentet që kemi marrë, disa prej të cilëve ripërtërihen në mënyrë periodike, sjellin jo vetëm bashkëngjitjen me Krishtin, por edhe bërjen sipas Tij.

Prej këtu rrjedh rëndësia për ta ripërtërirë gëzimin e dëshmisë që, ky vit baritor, i cili tashmë është drejt fundit,

ka pasur si objektiv kumtimin e emrit shumë të shenjtë të Jezusit, atë emër për të cilin lavdërohem që e kemi të vulosur në mishin tonë, “vula” e vënë prej Krizmës së shenjtë në Pagëzim, në Krezmim dhe në Urdhrin e shenjtë: një shenjë e pashlyeshme që askush nuk mund ta heqë apo ta fs hijë.

Në fuqi të kësaj vule që na bashkon të gjithëve, kemi detyrë morale ta ripërtërijmë jetën e bashkësisë së krishterë të Arqidioqezës sonë dhe, ashtu siç kam thënë në kremtimin e 70-vjetorit tim, dëshiroj fortësisht “një Kishë marrëdhëniesh, ku bashkëndahet pasioni dhe përkujdesja baritore për ta çuar njerëzimin te Hyji. Një Kishë mbarështuese ku anëtarët e saj dinë të bashkëpunojnë mes tyre,

duke reshtur së qeni shkëmbinj monolitë që ecin për hesap të tyre si solistë, por të krijojnë harmoni korale mes tyre. Kjo do të thotë përfshirje e laikëve në veprimin baritor të meshtarëve në famulli dhe te meshtarëve në dioqezë”. Vallë, a nuk është kjo domethënia e kremtimit të sotëm?

Dhe tani po ju drejtohem juve, shumë të dashur meshtarë. Shpesh, në takimet tona të formimit të përhershëm që kemi pasur gjatë këtij viti baritor, është paraqitur me urgjencë nevoja e rigjallërimit të jetës sonë meshtarake duke i përdorur të gjitha mjetet njerëzore dhe shpirtërore që kemi në dispozicion dhe që Provania e Hyjit edhe në vazhdim do të na vërë në dispozicion.

Le të bëjmë si Jezusi, le ta kemi forcën dhe guximin që “t’i lëmë gjërat, aktivitetet”, për të qëndruar vetëm me Hyjin dhe me veten tonë, në heshtje dhe në lutje, prej nga ku marrim energjitë shpirtërore e fizike të nevojshme për të qenë dhe për të dhënë më të mirën tonë.

Tani ripërtërimi premtimet tuaja meshtarake (edhe unë do t’i ripërtërij së bashku me ju!): janë po ato premtime meshtarake që kemi bërë ditën e shugurimit tonë meshtarak, duart tona në duart e Ipeshkvit shugurues! Ripërtëritja e tyre na bën mirë! Na ripërtërin përpara Hyjit dhe përpara Kishës, që është ky popull i shenjtë, që prej nesh kërkon urti, maturi dhe zell baritor.

Dhe ju shumë të dashur besimtarë, lutuni gjithmonë për meshtarët, lutuni edhe për mua dhe për thirrje të reja meshtarake!

Po e përfundoj me urimin e sinqertë që ta jetoni Pashkën 2019 si një angazhim të gëzueshëm dhe të ripërtërirë për t’i përkatur totalisht Krishtit dhe për të gjithë, barinj e grigjë, lutem që Hyji të tregohet i mëshirshëm me ju, që Nëna e Këshillit të Mirë t’ju shikojë me dashamirësi dhe Martirët tanë t’ju mbrojnë kudo që të jeni.

† Imzot Angelo Massafra O.F.M. - Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult



VIZITA BARITORE E IMZOT ANGELO MASSAFRA NË FAMULLINË E SHËN KOLLIT SHKREL MALESIA E MADHE, 23, 24 QERSHOR 2019

Festa e Korpit të Krishtit në famullin tonë ishte në një klimë të vertet feste ku gjithçka ishte përgatitur bukur për pritjen e Bariut tonë Mons Angelo Massafra në viziten baritore të ralles.

Ndales e parë e bëri në kishën e Shën Mëhillit në Boge ku u pritë nga famullitari dom Nikolin Toma dhe një numer i mirë besimtaresh. Në orën 9,00 filloj meshën në solemnitete sa ku kori i vogël i bashkësisë shoqërohet me këngë liturgjike përkatse.

Në fillim mons Angelo na njoftoi për rëndësinë e vizites baritor dhe programin e lutjes për paqë që kishte organizuar në shkallë dioqezane. Gjatë homeli ipeshkvi porositi që bashkësia e krishterë të mos të trembet por të qëndroj me besim në duartë Zotit.

Mbas meshët në frymë vllaznore u zhvillua një bashkëbisedim duke trajtuar problemet që e shqetësojnë dhe kanëvojë bashkësi.

Ndalesa e dytë u bë në qendër të famullis së Shkrelit tek kisha e Shën Kollit ku edhe këtu u pritë nga një numer i madh besimtaresh me në krye famullitarin. Duke theksuar vazhdoj "Jam shumë i kënaqur që filloj vizitën baritore në famullin tuaj dhe siç e dini, tradicionalisht konsiderohet si një nga detyrat më të rëndësishme të misionit të ipeshkvit. Vizita baritore është në thelb prania e ipeshkvit në bashkësinë e krishterë dhe, duke u mbështetur në përvojat e konsoliduara në këtë fushë, ka për qëllim rritjen e jetës së krishterë, nëpërmjet inkurajimit për gjëra të mira". Më pas trajtoj edhe shumë tema të ndryshme që e shqetësojnë bashkësinë e krishtenë dhe në frymë atërore la disa porosi për t'i zbatuar. Bashkëbisedimi me besimtarët dhe trajtimi i çështjeve me seriozitet u duk çartë kujdesi i veçantë që arqipeshkvi kishte për famullinë e Shkrelit. Në fund një ndër përshkrimet e mira që vlen të kujtohet takimi me animatorët dhe bashkëbisedimi i lirë dhe drekë vllaznore kaluar së bashku.

Udhëtimi jonë nuk do të ndalej këtu, por mbas drekë takimi me bashkësinë e vogël të Kishës së Zojës Bore në Sterkuj. Edhe pse e vogël në numer por shumë mikëpritëse dhe bujare. Duke shikuar numerin e vogël i dha një kurajo të veçantë duke theksuar se është një mundësi për të ringjallur energjitë e punonjësve ungjillorë, për t'i lavdëruar, për t'i inkurajuar ata dhe t'i ngushëlluar; është gjithashtu rasti të kujtojmë të gjithë besimtarët për rinovimin e jetës së tyre të krishterë dhe për një veprim më intensive apostolik. Gjatë këtij takimi u

vlerësuar bashkëpunimi me famullitarin me besimtarët në projektet për të ndërtuar një bashkësi më funksionale.

Një vend të veçantë ju rezervua rrënojave të vjetra të kishave dhe varrezave të vjetra që kanë një vlerë të madhe kulturore dhe fetare. Vizituam kishat e vjetra në Bzhet dhe Kolaj Zogor që i përkasin kohës së hershme të krishtenve të vjetër.

Në fillimin e ditës së dytë të qëndrimit në famullin e Shkrelit mons Angelo Massafra i shoqëruar nga famullitari dom Nikolin Toma bëren disa vizita të sëmuarit e famullis ku njoh me nevojat dhe problemet e tyre në jetën e përditshme. Gjatë këtyre takimeve u vërejt se kjo shtresë ka shumë nevojë për shërbim më të veçantë.

Në vazhdimësinë e vizites baritore arqipeshkvi u ndalën në bashkësinë e Ducajve në kishën e Shën Dhimitrit për të kremtuar meshën

shenjte dhe për tu njohur më mirë me gjendjen e kësaj bashkësie. Gjatë meshës arqipeshkvi u lut për paqen në vendin tonë dhe situatën që jemi duke kaluar njëkohsisht edhe për të sëmuarit dhe emigrantat. Mbas meshët u bë një dialog vllaznor duke vlerësuar vështësitë e të së kalueses dhe njëkohësisht angazhimet për të ardhmen.

Mbasi arqipeshkvi mons Angelo Massafra i shoqëruar nga famullitari dom Nikolin Toma vizituan të gjithë fshatrat e zonës dhe u njohën me gjendjen e tyre dhe së fundmi u ndalën në fshatin Vrihtë në kishën e Shën Nana Tereze. Në këtë bashkësi u pritë nga një numer i madh i besimtarëve që kishin ardhur enkas për këtë rast. Nën tingujt e kumbones filloj mesha shejte ku arqipeshkvi bëri një hyrje qëllimit të vizites dhe të kujdesit që ka grigjen e

tenzot. Gjatë homelis mons Agelo theksoj për bashkëpunimin e mirë që ekziston por nuk la pa përmendur edhe vështësitë e punës në ungjillëzimin e popullit tonë për mungesën e meshtarëve. Mbas meshët bëri një bashkëbisedim vllaznor duke trajtuar problemet me detaje dhe duke i shpjeguar në disa raste ku çështjet ishin të ndërlikuara. Gjatë bisedës u vërejt qart rëndësia e bariut në mes grigjes, ku në tërësinë e saj e bëri unike dhe i dha një frymëzim dhe kurajo për të kapërcyer vështësitë që do të hasim gjatë ecjes në jetë.

Së fundmi arqipeshkvi u largua duke na lënë porosin që të qëndrojmë të bashkuar në lutje dhe të jemi ndërtues të paqes dhe të flakim çfarë nuk i përket asaj.

24 Qershor 2019.

Kronisti nga Shkreli



MESHA E SHENJTË DHE HOMELIA E ATIT TË SHENJTË SHESHI MAQEDONIA (SHKUP), E MARTE, 7 MAJ 2019

«Kush vjen te unë nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua nuk do të ketë më etje», sapo na ka thënë Zoti (Gjn 6,35).

Në Ungjill, përreth Jezusit, mbledhet një turmë e madhe që ende e kishte të freskët kujtimin e shumëzimit të bukëve. Ky është njëri prej atyre momenteve që kanë mbetur të ngulitur në sytë dhe në zemrat e bashkësisë së parë të nxënësve. Ishte bërë një festë... Festa për të zbuluar bollëkun dhe nxitjen që Hyji u bën bijve të vet, të bërë vëllezër në ndarjen dhe në bashkëndarjen e bukës. Le ta imagjinojmë për një çast këtë turmë. Diçka kishte ndryshuar. Për disa çaste, ata persona të etur dhe të heshtur, që ndiqnin Jezusin në kërkim të një fjale, kanë qenë në gjendje të preknin me duart e tyre dhe të ndienin me trupat e tyre mrekullinë e vëllazërisë, që dilte e tepronte.

Zoti ka ardhur për t'ia dhënë jetën botës dhe e bën në atë mënyrë që sfida në ngushtësinë e llogaritjeve tona, mediokritetin e pritshmërive tona dhe sipërfaqësinë e intelektualizmave tanë; vë në pikëpyetje këndvështrimet tona dhe siguritë tona, duke na ftuar që të kalojmë në një horizont të ri, që i jep hapësirë një mënyre të re të të ndërtuarit të realitetit. Ai është Buka e gjallë që zbret prej qiellit, «kush vjen te unë nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua nuk do të ketë më etje» (Gjn 6,35).

Të gjithë ata njerëz zbuluan se uria e bukës kishte edhe emra të tjerë: uri për Hyjin, uri për vëllazërinë, uri për takim dhe festë.

Jemi mësuar të hamë bukën e fortë të dizinformimit dhe kemi përfunduar të burgosur të namit të keq, të epiteteve dhe të çnderimit; kemi besuar se konformizmi do ta kishte shuar urinë tonë dhe kemi përfunduar të pimë indiferencë dhe pandjeshmëri; jemi ushqyer me ëndrra të shkëlqimit dhe të madhështisë dhe kemi mbaruar për të ngrënë hutim, mbyllje dhe vetmi; jemi ngopur me lidhjet online dhe kemi humbur shijen e vëllazërisë. Kemi kërkuar një rezultat të shpejtë dhe të sigurt dhe gjendemi të shtypur prej padurimit e ankthit. Robër të virtualitetit, kemi humbur shijen e realitetit.

Le ta themi me forcë e pa frikë: kemi uri, o Zot... Kemi uri, o Zot, për bukën e Fjalës sate që është e aftë t'i hapë mbylljet dhe vetmitë tona; kemi uri, o Zot, për vëllazëri ku indiferenca, nami i keq dhe çnderimi të mos i mbushin tavolinat tona dhe të mos vihen në krye të vendit në shtëpinë tonë. Kemi uri, o Zot, për takime ku Fjala jote shton shpresën, zgjon butësinë, sensibilizon zemrën duke hapur rrugë shndërrimi dhe kthimi.

Kemi uri, o Zot, që të provojmë, ashtu siç bën turma, shumëzimin e

mëshirës sate, e cila është e aftë të thyjë stereotipet dhe të ndajë e bashkëndajë zemërdhembshurinë e Atit për çdo person, sidomos për ata për të cilët nuk kujdeset askush, që janë të harruar apo të përçmuar. Le ta themi me forcë e pa frikë, kemi uri për bukë, o Zot: për bukën e fjalës sate dhe për bukën e vëllazërisë.

Pas pak çastesh, do të vihem në lëvizje, do të shkojmë në tryezën e altarit për t'u ushqyer me Bukën e Jetës duke ndjekur urdhrin e Zotit: «Kush vjen te unë nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua nuk do të ketë më etje» (Gjn 6,35). Është e vetmja gjë që Zoti na kërkon: ejani. Na fton që të vihem në ecje, në lëvizje, na fton që të dalim. Na nxit që të ecim drejt Tij për të na bërë pjesëmarrës të jetës dhe të misionit të tij. "Ejani", na thotë Zoti: një "ejani" që nuk do të

thotë vetëm të zhvendosemi nga një vend në një tjetër, por që të kemi aftësinë për ta lënë veten që të zhvendosemi, që të shndërrohemi prej Fjalës së tij në zgjedhjet tona, në ndjenjat tona, në përparësitë për të bërë gjestet e tij dhe për të folur si Ai, «gjuhën e bukës që do të thotë butësi, shoqëri, përkushtim bujar ndaj të tjerëve», dashuri konkrete dhe e prekshme, sepse është e përditshme dhe reale. Në çdo Eukaristi, Zoti thyhet e shpërndahet dhe na fton edhe ne që të thyhemi e të shpërndarhemi së bashku me Të dhe të marrim pjesë në atë mrekulli shumëzuese, që

dëshiron të arrijë dhe të prekë çdo cep të këtij qyteti, të këtij Vendi, të kësaj toke me pak butësi dhe zemërdhembshuri.

Uri buke, uri vëllazërie, uri Hyji. Sa mirë e dinte këtë gjë Nënë

Tereza, aq sa ka dashur ta bazojë jetën e vet mbi këto dy shtylla. Jezusi i mishëruar në Eukaristi dhe Jezusi i mishëruar tek të varfrit! Dashuri që marrim, dashuri që japim. Dy shtylla të pandashme, që kanë shënuar ecjen e saj, që e kanë vënë në lëvizje, plot me dëshirën për të shuar urinë dhe etjen e saj. Ka shkuar te Zoti dhe me të njëjtin akt ka shkuar te vëllai i përçmuar, jo i dashur, i vetëm dhe i harruar; ka shkuar te vëllai dhe ka gjetur fytyrën e Zotit... Sepse e dinte që «dashuria për Hyjin dhe dashuria për të afërmin

shkrihen së bashku: në më të voglin takojmë vetë Jezusin dhe në Jezusin takojmë Hyjin», dhe kjo dashuri ishte e vetmja gjë që ishte e aftë për të shuar urinë e saj.

Vëllezër, sot Zoti i Ngjallur vazhdon të ecë në mesin tonë, aty ku kalon dhe aty ku jetohet jeta e përditshme. Ai e di urinë tonë dhe për këtë na thotë: «Kush vjen te unë nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua nuk do të ketë më etje» (Gjn 6,35). Le t'i japim zemër njëri-tjetrit për t'u ngritur në këmbë dhe për të provuar bollëkun e dashurisë së Tij; le të lëmë që Ai ta shuajë urinë dhe etjen tonë në sakramentin e altarit dhe në sakramentin e vëllait.



FJALIMI I ATIT TË SHENJTË FRANÇESKU

SHTEGTARËVE ITALO-SHOIPTARË TË EPARKISË SË LUNGRIT ITALI

Salla Pali VI

E shtunë, më 25 maj 2019

Shumë të dashur vëllezër e motra,
Christós Anésti!

Jam i gëzuar që jemi të mbledhur këtu dhe që po jua drejtoj secilit prej jush këtë përshëndetje të përzemërt. Me këtë rast, atë të 100-vjetorit të Kushtetutës Apostolike Catholici fideles, me të cilën Papa Benedikti XV ngrinte Eparkinë e Lungros, ju keni ardhur në Romë, me Bariun tuaj Imzot Donato Oliverio-n, për të treguar përpara mbarë Kishën katolike fenë dhe bashkimin e Bashkësisë sonë të dashur. Ju falënderoj për këtë vizitë dhe për dëshminë që bëni.

Njëqind vite më përpara, ndërsa bota vuante pasojat e Luftës së Parë Botërore, Paraardhësi im i nderuar është vënë në dëgjim të historisë, të kërkesave tuaja legjitime, ashtu si edhe të itineratit tuaj të guximshëm shpirtëror, të karakterizuar prej besnikërisë ndaj traditës, me gjithë vështirësitë e vuajtjet që keni përjetuar. Papa e kishte fort për zemër Kishën lindore dhe meditonte «se çfarë duhej të bënte për t'i plotësuar më me qëndrueshmëri nevojat dhe traditat e Kishës universale dhe të Kishave të tjera të veçanta». Për këtë arsye dekretonte se «menjëherë kishte ngritur kanonikisht dioqezën e ritit grek në tokën e Kalabrisë» (Bulla Catholici fideles).

Ky përvjetor i rëndësishëm përbën një mundësi për ta falënderuar Zotin për atë që, në mirësinë dhe mëshirën e tij, ka vepruar në Bashkësinë tuaj gjatë shekujve të fundit. Për këtë arsye ju ftoj që ta jetoni këtë jubile jo aq si një pikëmbërritje, por si një hov të ri dhe të gëzueshëm në angazhimin tuaj njerëzor dhe në ecjen tuaj të krishterë. Në këtë kuptim, është e nevojshme që të thellojmë njohjen e të kaluarës dhe që të jemi mirënjohës ndaj saj, për të gjetur në të arsyet e shpresës dhe për të ecur së bashku drejt të ardhmes që Hyji dotë na japë.

Ju nxis që ta pranoni gjithnjë e më shumë në ju dhe mes jush dashurinë e Zotit, burim dhe motiv të gëzimit tonë të vërtetë, për të marrë pjesë në Sakramente, për të treguar afërsi ndaj çdo familjeje, për t'i kushtuar vëmendje më të varfërve dhe më nevojtarëve, për të shoqëruar brezat e ri me sfidën e madhe edukative që na përfshin të gjithëve: këta janë përmasat ku duhen ruajtur traditat tona, ashtu si edhe përkatësia jonë ndaj

Krishtit dhe Kishës. Jeni të thirrur që të jetoni si të krishterë, duke dëshmuar që dashuria është më e bukur sesa urrejtja, që miqësia është më e mirë sesa armiqësia, që vëllazëria mes të gjithëve është më e bukur sesa konfliktet.

Lutja dhe mirënjohja jonë sot i kushtohet edhe atyre që së bashku me ne gëzojnë prej qiellit. Të gjithë ata që ju kanë përçuar fenë me jetën e tyre më përpara sesa me fjalët e tyre, në veçanti mendoj për Ipeshkvijtë, meshtarët, rregulltarët, prindërit e gjyshërit që ju kanë paraprirë dhe që besnikërisht kanë ruajtur dhe përçuar pasuritë e Traditës suaj të bukur. Imitoni shembullin e tyre dhe përçojuani brezave të ri këtë pasuri shpirtërore që ju identifikon.

Ju shoqëroftë në ecjen tuaj të përditshme mbrojtja amënore e Nënës së Hyjit, Odegitria. Ajo, shërbëtorja e dëgjueshme që ka pranuar fjalën e Zotit, ju bëftë gjithnjë e më të butë ndaj vullnesës së Atit dhe mjete bujare të planit të tij të shpëtimit.

Të dashur vëllezër e motra, faleminderit sërish për këtë vizitë, dhe shumë urime për 100-vjetorin tuaj! Ju kërkoj që të luteni për mua dhe me gjithë zemër ju jap Bekimin tim, që me shumë dëshirë ua shtrij edhe familjeve tuaja dhe krejt Eparkisë së Lungrit.



ATI I SHENJTË PAPA FRANÇESKU NË KUJTIM TË PËRJETSHËM



«Një shumicë në Izrael qenë të guximshëm e qëndroi e fortë e nuk hëngri ushqime të papastërta: më parë zgjodhën vdekjen se të ndoten me ushqime të papastërta e ta prishin Besëlidhjen e shenjtë» (1Mak 1,62-63).

Ashtu siç na mëson Libri i Parë i Makabejve, në vorbullën e përndjekjeve nuk mungonin ata që për dashuri ndaj Hyjit dhe ligjit të Tij duronin me qëndresë të qetë dhe në paqe mundimet e shumëfishta dhe që qenë të gatshëm ta jepnin jetën e tyre për ta gjetur atë në Hyjin. Ndërsa përndjekësit zhduken si hije në errësirën e një harrese të përjetshme, martirët shkëlqejnë si shkëndijë drite në qiell.

Në këtë mënyrë edhe të Nderuarit Shërbëtorë të Kishës në Shqipëri, viktimë të përndjekjes së shek. XX, kanë sjellë fitoren, duke qenë se kanë treguar ndaj armiqve po ato ndjenja dhe qëndrime që ka pasur edhe Krishti (Fil 2,5): falje, ndershmëri, qëndresë, vëllazëri, zemërdhembshuri. Historia e vuajtjeve, e martirizimit dhe e lavdërimit të këtyre XXXVIII heronjve të fesë, filloi në vitin 1944, kur një fuqi e padrejtë dhe e mbrapshtë pretendoi ta fshinte emrin Shumë të Shenjtë të Zotit prej tokës fisnike të Shqipërisë. Megjithatë, feja nuk arriti kurrë të çrrënjosej prej këtij vendi. Zoja e Këshillit të Mirë, Pajtorja e Kombit shqiptar, prej shenjtërores së saj të përdhosur të Shkodrës, vazhdoi të rrezatonte në zemrat e besimtarëve ngushëllim dhe shpresë. Përndjekja, që zgjati për më shumë se 40 vjet, u bë kundër çdo tipologjie e klase besimtarësh, klerikësh, rregulltarësh dhe laikësh, të rinj dhe të moshuar, të çdo prejardhjeje sociale dhe kulturore. Ata u vranë mizorisht, u poshtëruan në gjyqe të rreme publike, u akuzuan për komplete që nuk kishin ndodhur kurrë.

Këta martirë janë:

I - Vinçenc, në shekull Nicolò, Prennushi, O.F.M., Ipeshkvi i parë i Sapës dhe pastaj Arqipeshkëv dhe Primat i Shqipërisë. Iu kundërvua përpjekjes për ta nacionalizuar Kishën, duke e shkëputur atë prej Romës: vdiq më 19 mars 1949 në burgun e Durrësit për shkak të keqtrajtimeve.

II - Frano Gjini, Ipeshkvi i parë me titull *Sempte* dhe abati *nullius* i Shën Llezhdrit të Oroshit, pra ipeshkvi i Lezhës që protestoi kundër politikës antifetare të regjimit: u pushkatua në Shkodër më 11 mars 1948.

Së bashku me të vdiqën edhe dy françeskanë:

III - Çiprijan Nikaj, në shekull Dedë, O.F.M. meshtar, dhe

IV - Mati, në shekull Pal, Prendushi, O.F.M., meshtar, Ministër Provincial.

Qysh në fillim regjimi deshi t'i zhdukte personalitetet më të rëndësishme të botës katolike, domethënë ata që merreshin me predikimin dhe formimin e ndërgjegjeve të njerëzve. Për këtë arsye në mars të vitit 1945 u pushkatuan dy barinj:

V - Lazër Shantoja, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 5 mars 1945 dhe

VI - Ndre Zadeja meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 25 mars 1945.

Më 4 mars 1946 u pushkatuan martirët:

VII - Giovanni Fausti, S.I., meshtar, lindur në Itali, ish-Rektor i Seminarit Papnor Shqiptar në Shkodër;

VIII - Danjel Dajani, S.I., meshtar;

IX - Gjon, në shekull Kolë, Shllaku, O.F.M., meshtar;

X - Mark Çuni, student në Seminarin e Shkodrës;

XI - Gjeloş Lulashi, laik, dhe

XII - Qerim Sadiku, laik, i martuar.

Në vende dhe në kohë të ndryshme pësuan pushkatimin edhe:

XIII - Alfons Tracki, lindur në Slesi, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, vranë më 18 korrik 1946;

XIV - Fran Mirakaj, laik, prind, vranë në muajin shtator 1946;

XV - Josef Marxen, lindur në Gjermani, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, vranë më 16 nëntor 1946;

XVI - Luigj Prendushi, meshtar i Arqidioqezës së Sapës, që vdiq më 24 janar 1947;

XVII - Dedë Maçaj, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 28 mars 1947;

XVIII - Anton Zogaj, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, që vdiq më 9 mars 1948;

XIX - Dedë Malaj, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 12 maj 1959;

XX - Marin Shkurti, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq në prill 1969;

XXI - Shtjefën Kurti, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, që vdiq më 20 tetor 1971;

XXII - Mikel Beltoja, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, që vdiq më 10 shkurt 1974.

Vdiqën nën tortura apo si pasojë e keqtrajtimeve:

XXIII - Bernardin, në shekull Zef, Palaj, O.F.M., në Shkodër, në kuvendin e kthyer në burg, më 2 dhjetor 1946;

XXIV - Serafin, në shekull Gjon, Koda, O.F.M., meshtar, në burgun e Lezhës, më 11 maj 1947;

XXV - Gjon Pantalija S.I., rregulltar, në Shkodër, më 31 tetor 1947;

XXVI - Mark Xhani (Gjani), meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, nën tortura në Shpal në vitin 1947;

XXVII - Dedë Plani, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, nën tortura më 30 prill 1948 në Shkodër.

Po atë vit u vranë meshtarë të tjerë të po kësaj arqidioqeze:

XXVIII - Ejëll Deda, në Shkodër, më 12 maj 1948;

XXIX - Anton Muzaj, në të njëjtin vend, nuk dihet data;

XXX - Pjetër Çuni, në Koplik, më 31 korrik, nën tortura;



XXXI - *Lek Sirdani*, më 26 dhjetor 1948, imbyturnëgjirizin e burgut të Koplikut (Shkodër);
XXXII - *Josif Papamihali*, meshtar i Rritit greko-katolik shqiptar, më 26 tetor 1948 në Maliq, i sfillitur prej punës së detyruar;
XXXIII - *Jak Bushati*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, për shkak të torturave, më 12 shtator 1949 në Lezhë;
XXXIV - *Gaspër, në shekull Kel, Suma*, O.F.M., më 16 prill 1950 në Shkodër;
XXXV - *Jul Bonati*, meshtar i Arqidioqezës së Durrësit, më 5 nëntor 1951 në Durrës;
XXXVI - *Ndoc Suma*, meshtar i Arqidioqezës së Shkodrës, më 22 prill 1958 në Pistull;
XXXVII - *Karl, në shekull Ndue, - Serreqi*, O.F.M., meshtar, që pësoi një martirizim të veçantë për të mos nxjerrë sekretin e rrëfimit dhe vdiq prej mundimeve në burgun e Burrelit, më 4 prill 1954;
XXXVIII - *Marije Tuci*, e vetmja grua e këtij grupi, aspirante për jetën rregulltare mes Motrave “Bijat e Varfra të Varrëve të Shenjta të Shën Françeskut të Asizit” (Stigmatine), vdekur më 24 tetor 1950, e shpërfytyruar prej xhelatit që donte të prekte dëlirësinë e saj.
Kisha në Shqipëri, e dalë prej katakombeve, me dashuri dhe devocion mblodhi provat e martirizimit të bijve të saj, me qëllim që dëshmia e tyre e çmueshme e fesë të kontribuonte dhe të ndërtonte bashkësinë e besimtarëve në Krishtin, e cila kishte qenë e detyruar të qëndronte në heshtje për shumë kohë.
Hetimi Dioqezan mbi martirizimin u bë pranë Kuries Arqidioqezane të Shkodrës prej datës 10 nëntor 2001 deri me datën 8 dhjetor 2010. Vlefshmëria juridike e tij u njoh prej Kongregatës së Çështjes së Shenjtërve me dekret të datës 9 mars 2012. Konsultorët Teologjikë të mbledhur në Kongresin e posaçëm, më 17 dhjetor 2015, dhanë mendimin në favor të martirizimit të tyre. Në të njëjtën mënyrë Etërit Kardinalë dhe Ipeshkvij në Seksionin e Zakonshëm të datës 19 prill 2016 njohën që këta Shërbëtorët e Hyjit u vranë për besnikërinë e tyre në Krishtin dhe Kishës.

Përkëtë arsye Ne, më 26 prill 2016, kemi autorizuar Kongregatën e Çështjes së Shenjtërve që të shpallë Dekretin e miratimit të martirizimit dhe të pas kemicaktuar qëriti solemn ilumnimit të zhvillohej në Shkodër, në Shqipëri, me datë 5 nëntor 2016. Në fund, sot në Shkodër për mandatin tonin, Vëllai ynë i nderuar Angelo Amato, Kardinal i Kishës së Shenjtë Romake dhe Prefekt i Kongregatës për Çështjen e Shenjtërve, ka lexuar tekstin e Letrës Apostolike me të cilën Ne kemi regjistruar në numrin e të Lumëve të nderuarit Shërbëtorë të Hyjit Vinçenc Prennushi O.F.M., Arqipeshkëvi Durrësit me XXXVII Shokë, martirë të Kishës në Shqipëri: NE DUKE PRANUAR DËSHIRËN E VËLLAIT TONË ANGELO MASSAFRA, O.F.M., ARQIPESHKËV METROPOLIT ISHKODËR-PULT, SIEDHETË VËLLEZËRVETË TË JETËRË TË SHUMTË NË EPISKOPAT DHE DËSHIRËN E SHUMË BESIMTARËVE, PAS KONSULTIMIT ME KONGREGATËN PËR ÇËSHTJEN E SHENJTËRVE, ME AUTORITETIN TONË APOSTOLIK DEKRETOJMË QË TË nderuarit Shërbëtorë të Hyjit Vinçenc Rennushi i urdhrorit të Fretërve Minorë, Arqipeshkëvi Durrësit me XXXVII Shokë, Martirë të Kishës në Shqipëri, që me shpirt heroik e mbajtën ndezur llambën e fesë në kohën e errët të përndjekjes, tash e prapa të quhen të Lumë dhe që festa e tyre të këmbehet çdo vit më 5 nëntor, në vendet dhe në mënyrat e përcaktuara prej të drejtës Kanonike. Në emërtë të Atit, e të Birit të Shpirtit Shenjt. Pra, ne me këtë rast gëzojmë së bashku me Kishën në Shqipëri për dëshminë e fortë të besnikërisë ndaj Krishtit të këtyre të Lumëve, mes të cilëve nderojmë shumë barinj dhe rregulltarë të zellshëm, poa shtu edhe laikë bujarë të gatshëm për t'uflijuar. Dhe kjo që dekretojmë, duam dhe caktojmë që të hyjë në fuqi menjëherë, pavarësisht çfarë do gjëje që mund të jetë kundër.

Dhënë në Romë, pranë Shën Pjetrit, nën unazën e Peshkatarit, më 5 nëntor 2016, i katërti i pontifikatit tonë.

Kard. Pietro Parolin - Sekretar Shteti



ZOTI THIRRI PRANË VETES VËLLAIN TONË DON SILVIO BRAGA

Don Silvio Braga lindi në Rodengo më 04.06.1942, u shugurua meshtar më 18.12.1994 në Shkodër, Shqipëri; ka qenë famullitar në Beltoja nga 1 shtator 1996 deri me 1 shtator 2015; u inkardinua në dioqezën e Breshas në vitin 2015.

Duke filluar nga sot pasdite, homazhet do të bëhen pranë Fondacionit Villa Zani RSA në Bieno.

Vigjilja mortore me Meshën e Shenjtë, të udhëhequr nga don Angelo Gelmini, Vikar për Klerin, do të kremtohet të hënën më 9 shtator në orën 16.00 pranë Fondacionit Villa Zani RSA në Bieno.

Funerali, i udhëhequr nga Shkëlqesia e Tij Imzot Pierantonio Tremolada lpeshkëvi i Breshas, do të bëhet të martën më 10 shtator në orën 15.00 pranë kishës famullitare të Saianos.

Don Silvio do të varroset në varrezat e Saianos.

Për të dhe familjarët e tij kujtimi ynë në lutje.

Letera e Arqipeshkvit Imzot Angelo Massafra

Shkodër, 09/09/2019

Shkëlqesi e Nderuar, shumë i dashur don Michelangelo dhe shumë të dashur familjarë të don Silvio Bragës, jam shpirtërisht i pranishëm në ritin e lamtumirës që kremtohet sot, njëkohësisht me atë që do të udhëheq në katedralen e Shkodrës për një tjetër meshtar misionar italian, Atë Antonio Bozza, dehonian.

Motra vdekje na ka vizituar me gjithë madhësinë e vet, duke na prekur në dashurinë presbiterale, por pa e shkatërruar në ne fenë se tani don Silvio, i pastruar nga sëmundja e gjatë, është duke kundruar faqe faqas fytyrën e Atij me të cilin Shpirti e kishte bërë të ngjashëm në sakramentin e Urdhrit të shenjtë. Tani ai kremton liturgjinë e amshuar të qiellit, atë me të cilën çdo ditë të jetës së tij është bashkuar ndërsa kremtonte liturgjinë tokësore.


Prandaj dhimbja i lë vendin ngushëllimit duke e ditur se është në paqen e Zotit, madje edhe më shumë: e ndiejmë të pranishëm pikërisht në këtë liturgji, falë kungimit që na bashkon dhe që vdekja nuk mund ta shkatërrojë. Dhe ngushëllimi i hapet falënderimit për dhurimin e jetës së tij Krishtit dhe vëllezërve, popullit shqiptar të

cilit ai i ka shërbyer me shumë mirësi, edhe kur matura njerëzore do të kishte sugjeruar më shumë kujdes. Duke mos kursyer asgjë nga vetvetja, i ka shtuar një copëz të çmuar rindërtimit të Kishës në Shqipëri pikërisht në momentin më delikat, atë të fillimeve.

Për të gjitha këto i themi faleminderit atij dhe Zotit që na e ka dhuruar: Don Silvio ka ardhur në Shqipëri pikërisht në fillim të rilindjes. U shugurua meshtar nga Imzot Frano Illia, Arqipeshkëvi i Shkodrës. Ka shërbyer në fillim në shumë fshatra, para se të emërohej famullitar në Beltojë, me dy fshatra, Ashtën dhe Kosmaçin. Në bashkëpunim me Motrat, ka ungjillëzuar besimtarët, ka ndihmuar të varfrit... Ka qenë ndërtues kishash; ka jetuar gjithmonë në varfëri, në përvujtëri dhe në shërbim, deri në fund. Sikur kushtet e shëndetësisë në Shqipëri do ta kishin lejuar, don Silvio do të kishte qëndruar deri sot në Shqipëri, dhe ndoshta në këtë moment do të kisha pasur dy arkivole para syve, për t'i stërpikur me ujë të bekuar dhe për t'i kemosur.

Prandaj, Shkëlqesi, ju lutem të bëheni paksa edhe dora ime kur të stërpikni dhe të kemosni trupin e don Silvios: nderimi që i rezervojmë trupit të vdekshëm le të dëftojë edhe më fort fenë tonë në Ringjalljen që është fjala e fundit e Krishtit mbi vdekjen tonë kur, në kthimin e tij, do të na bashkojë të gjithëve për të shëruar dhimbjen e sh këputjes së tashme. Pusho në paqe, don Silvio, ipeshkvi yt dhe e gjithë Kisha lutet për ty, por edhe ti vazhdoje shërbesën tënde nga parajsa dhe lutu për ne e për besimtarët e famullisë së Beltojes (Shkodër).

+ Angelo Massafra O.F.M. Metropolit i Shkodër-Pultit



FUNERALI PËR ATË ANTONIO BOZZA, DEHONIAN Në Shqipëri që nga viti 2000

Më 8 shtator 2019, pak mbas dreke, në një spital në Tiranë ndërroi jetë duke u kthyer në Shtëpinë e Atit, meshtari dehonia atë Antonio Bozza, famullitarë në zonën e Boriqit Shkodër.

Pas lutjeve dhe meshës që u mbajt në kishën e Boriqit ditën e hënë, dt. 9 shtator, e cila u kryesua nga Sh. T. Imzot Simon Kulli, të martën dt. 10 shtator, arkmorti me trupin e tij u transferua në Kishën Katedrale ku u kremtua mesha nga Arqipeshkvi ynë, Imzot Angelo Massafra dhe shumë meshtarët si dhe nga një numër i madh besimtarësh.

Në homelinë e tij Sh. T. Imzot Massafra nënvizoi disa momente nga jeta e atë Antonios

Ai, kujtoi që at Bozza ka ardhur në Shqipëri nga viti 2000 dhe se në jetën e tij si rregulltar e meshtar ai bënte pjesë në Kongregatën e Zembrës së Krishtit, e themeluar nga Atë Dehon. Ky i fundit, duke parë problemet që i shkakttoheshin fesë nga Iluminizmi është frymëzuar prej Zotit për të përtërirë Kishën.

Përshpirtëria e etërve dehonianë është ajo që atë Antonio e ka mësuar që kur ishte adoleshent në kolegjin e etërve dhe që pastaj e ka jetuar gjatë gjithë jetës së tij. Kjo përshpirtëri përmban:

Shpirtin misionar, ungjillëzimin; angazhimin në fushën e mediave, në botimet e Etërve dehonianë, për të bërë të njohur doktrinën shoqërore të Kishës, pas enciklikës Rerum Novarum, të Papës Leoni XIII; kushtimin Zembrës së Krishtit dhe lutjen me pendesë për ndreqjen e fyerjeve bërë Zembrës së Krishtit.


Atë Antonio, si dehonian i mirë, e ka jetuar jetën e vet sipas kësaj përshpirtërie. Ndër të tjera Arqipeshkvi tha se do të donte ta përkujtoj më shumë se si atë Antonio: ai kishte për zemër të varfrit, të cilët i ndihmonte së bashku me motrat baziliane dhe se kishte një devocion të madh për shna Ndoun e Padovës: së bashku të kishin

restauruar rrënojat e Manastirit Benediktin në Shëngjin (Vrak), me devocionin e bukur dhe të frekuentuar të 13 të martave të shna Ndout. Ai ka qenë një bashkëpunëtor i madh dhe një punëtor i thjeshtë, shumë afër bashkësive rregulltare, i gatshëm për çdo lloj ndihme.

Atë Antonio Bozza do të kujtohet nga ne pasi ka qenë shumë i angazhuar në procesin për Lumnimin e martirëve tanë; në Radio Marinë Shqiptare në fillimet e saj; në Karitas-in D i o q e z a n ; në administrimin ekonomik të dioqezës; në kontrollimin e librave të ndryshëm që si Dioqezë janë publikuar si d h e n ë v e p r ë n e kompjuterizimit të të

dhënave regjistrave të sakramenteve të shumë famullive dhe të të dhënave të arkivit që kishim marrë nga Shteti, pas konfiskimit, në mikrofilma dhe me përshkrimin përkatës.

Ë fund Arqimeshkvi ynë pati një falënderim ndaj familjes Bozza, Kongregatës Dohoniane për misionin në Shqipëri, të gjithë atyre që e kanë ndihmuar, sidomos në ditët e fundit të jetës së tij. Atë Antonio, faleminderit. Zoti të pranoftë në Parajsë. Dhe lutu për ne.



MESAZH PËR DITËN BOTËRORE TË RINISË

13 prill 2019

Shumë të dashur të rinj,
ja ku jemi sërish bashkë për të kremtuar Ditën që, tashmë prej shumë vitesh, Kisha jua ka kushtuar juve: është një moment i rëndësishëm për t'ju thënë e rithënë se sa të rëndësishëm jeni në sytë e Hyjit, që ju do me një dashuri të pafundme. Në ju ka potencialitet dhe shpresë “për të sotmen dhe për të ardhmen” si për shoqërinë, ashtu edhe për Kishën që, pikërisht për këtë gjë, ju qëndron afër, siç ka bërë me Sinodin e fundit kushtuar juve dhe me dokumentin që Papa Françesku ka firmosur pak ditë më parë, pikërisht më 2 prill 2019.

Në Sinod, ipeshkvijtë e mbarë botës kanë pasur mundësi t'ju dëgjojnë, për t'u njohur me pritshmëritë dhe shpresat tuaja. Nuk kanë dashur të thonë se kush jeni ju, por kanë bërë të mundur që ju vetë të thoni se kush jeni, të vetëdijshëm për autonominë e mendimit tuaj dhe për aftësinë e gjykimit tuaj. Ata nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë mikpritur kërkesat tuaja dhe ju kanë siguruar për afërsinë e tyre, të cilën Papa jua ka shprehur nëpërmjet dokumentit pas-sinodal, të cilin do ta marrim në shqyrtim një herë tjetër.

Sot gjendemi këtu për të festuar; për të qenë si të rinjtë e Jerusalemit, që mikpresin me zemrën plot gëzim hyrjen e Jezusit, gati si të donim të përsërisnim edhe ne atë “Hosana!”, duke njohur në Të Birin e Davidit, Mesinë, Shpëtimtarin, madje Shpëtimtarin e vetëm. Jo si të gjithë ata shpëtimtarë që sot na paraqiten, sidomos ju të rinjve, duke ju krijuar shpresa të rreme pasurimi, fame (nam), lavdie, bukurie të jashtme dhe pushteti... me një fjalë duke ju paraqitur gjëra që kalojnë.

Jezusi Shpëtimtar na propozon një gëzim tjetër, të brendshëm, të fortë, të aftë për t'i kapërcyer vështirësitë, që në mënyrë të pashmangshme jeta na vë përpara. Nuk mund të mos sjell ndër mend në këtë moment ata të rinj, të cilët si ju, gjatë përndjekjes komuniste në Shqipëri, ia kanë dhuruar me gëzim jetën e tyre Krishtit. Më vijnë ndër mend të Lumët Fran Mirakaj, Gjelosh Lulashi e Qerim Sadiku: nuk ishin meshtarë, rregulltarë apo seminaristë, ata ishin të rinj entuziastë për Jezu Krishtin dhe për Atdheun e tyre dhe për këtë arsye nuk ngurruan ta jepnin jetën e tyre për fitoren e Krishtit Mbret dhe për shpëtimin e Shqipërisë prej ateizmit, ideologji kjo që e kthen njeriun në diçka thjesht materiale.

Sot, për fat të keq, nuk jetojmë kohë edhe aq të ndryshme. Armiku i

njerëzimit dhe i Kishës përdor mjete të holla dhe inteligjente: nuk bën më luftra të drejtpërdrejta, por paraqitet në forma të reja dhe joshëse për t'i larguar, sidomos të rinjtë dhe adoleshentet, prej fesë. Uroj që, urtësisht të drejtuar prej prinderve, prej meshtarëve dhe edukatorëve tuaj, të dini t'i dalloni këto forma dhe me guxim, me guximin e Martirëve tanë, të dini të thoni jo.

Për këtë arsye ju ftoj që të ruheni mirë prej gjithçkaje që i jep rëndësi vetëm anës së jashtme (edhe asaj fizike, me të gjitha pasojat e veta) në dëm të anës së brendshme: Shën Françesku i Asizit thoshte se njeriu vlen aq sa vlen në sytë e Hyjit.

Ruhuni mirë e mos ndiqni ideale pushteti dhe zotërimi të tjetrit, që nuk kanë lidhje me të vepruarit e Jezusit “zemërbutë dhe të përvuajtë”, që këto ditë sodisim në Mundimet e Tij si Shërbëtor që vuan.

Ruhuni mirë prej çdo forme arratisjeje, jo vetëm asaj fizike prej Atdheut tuaj, por edhe asaj morale që ka shijen e mosangazhimit: kemi detyrë të lëmë një gjurmë pozitive gjatë kalimit tonë në këtë botë, për të mos qenë fajtorë me lëshime, që na bëjnë keq neve personalisht, Kishës dhe shoqërisë.

Ndërkohë ju ftoj që ta bëni tuajën temën e Ditës Botërore të Rinisë që këtë vit është mbajtur në Panama: “Unë jam shërbëtorja e Zotit: më ndodhtë siç the ti!” (Lk 1,38), për t'i thënë, ashtu si edhe Maria e Nazaretit, edhe ju “po”-në tuaj Zotit, sepse edhe një herë, falë jush, Zoti hyn në këtë histori për ta ndryshuar atë nga brenda dhe për t'i dhënë një drejtim të ri, atë të Ngjalljes.

Kisha ka besim te forcat tuaja të reja, te aftësitë tuaja për të pasur ideale të mëdha dhe te guximi juaj për t'i mundësuar Hyjit që të shfaqet në tokën shqiptare si Shpëtimtari i vetëm i saj.

Ky është urimi im për ju me rastin e kësaj Pashke 2019: jini të gëzueshëm dhe shpallës të guximshëm të Emrit të Jezusit në të gjitha rrethanat ku jetoni; dëshmojeni me jetën tuaj, me shembullin tuaj të pastërtisë dhe të idealeve të mëdha: thuajuni të gjithëve se sa bukur është t'i përkasësh Krishtit. Jezusi i Ngjallur ju bekoftë të gjithëve ju, e bekoftë rininë tuaj dhe i bekoftë familjet tuaja, të cilave ju lus që t'ua përçoni urimet e mia për këtë Pashkë të shenjtë.

Ju falënderoj për faktin se jeni gjymtyrë të gjalla dhe të reja të trupit të Krishtit, që është Kisha. Ju bekoj.

† Imzot Angelo Massafra O.F.M. Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult

TAKIMET E FORMIMIT TE JUNIOREVE

Takimi i dytë i junioreve u mbajtnga 4-6 janar në Seminarin Ndërdioqezan – Shkodër, nga motër Michaela Kubickova, saleziane me temën: “Gruaja,nga Bibla në Kishë”.

Motër Michaela e filloi re ferimin e saj në pikën më të lartë të personit njerëzor, në përngjasimin/ngjashmërinë me imazhin e Zotit, duke theksuar që Zoti është shumë më shumë.

Burri dhe gruaja kanë shumë aspekte të përbashkëta mes tyre, por kanë dhe veçoritë e tyre: në Zotin për mbushen të dy. Si figure biblike, motra ka marrë shembull mbretëreshën Ester, e cila me



zgjuarsinë e saj, me lutjen, agjërimin, ndjeshmërinë e sajprejgruaje, arriti që të shpëtojë popullin e vet, duke rrezikuar edhe jetën e saj.

Duke bërë lidhjen mes mbretëreshës Ester dhe gruas së kushtuar, ajo theksoi disa pika të identitetit tonë si të kushtuara:

- Të kemi Krishtin si pikë re ferimi qendror të jetës sonë;
- Të jetojmë lumturinë sepse jetojmë me Të;
- Të kemi shikim pozitiv mbi jetën dhe realitetin;
- Të zhvillojmë gjithë e më tepër gatishmërinë për të ndihmuar;
- Të jetojmë jetën me qëndrim shërbimi;
- Të zhvillojmë aftësinë për t'u dhënë kurajë e shpresë personave që takojmë në rrugët e jetës sonë;
- Të gëzohemi me ata që gëzojnë dhe të qajmë me ata që qajnë.

Ndër shumë propozime të rrejshme mbi lumturinë që ofron bota e sotme, lumturia jonë e vërtetë qëndron në një kërkim të vazhdueshëm të dashurisë së Zotit; vetëm Ai e përmbush jetën tonë.

Motra na ka dëftuar në Virgjëren Mari gruan e përsosur e cila nuk refuzon edhe nëse l ndryshojnë planet, zbaton zakonet dhe ligjin, është gjithmonë pranë Jezusit dhe është aty ku është Kisha.

E falenderojmë për zemërsisht mt. Michaela për këtë nxitje dhe bashkëndarje që me shumë zell na e ka përcjellur.

Motër Gjyste Doda
Motër Vera Preqi

25-VJETORI I INSTITUTIT RAVASCO NË SHOIPËRI

“Mbrëmë, me 29 tetor 1994, në orën 22.30, jemi nisur nga porti i Barit me anijen Palladio, për në drejtim të tokës Shqiptare, motër Anna Maria Fuschi, motër Giuliana Zaffiri, motër Maria Carmina Schieda dhe motër Maria Paula Molina.”- këto janë rreshtat e parë të ditarit të shtëpisë në Shkodër.

Falë ndihmës së Provanisë, të mishëruar në ndihmën bujare të shumë bamirësve dhe të sakrificës së përkushtuar të bashkëmotrave që kanë banuar dhe që kanë shërbyer gjatë këtyre viteve, tani mund të themi që kemi realizuar një ëndërr e cila është një përgjigje e një thirrjeje të mirëfilltë për t’iu sjellur gëzimin e Ungjillit të gjithë atyre që u është mohuar: në fillim nga një ateizëm i imponuar ndërsa tani nga një materializëm konsumist i cili i heq njeriut shijen e të kërkuarit dhe të zbuluarit të kuptimit të vërtetë të jetës, duke prodhuar nevoja jo të domosdoshme dhe duke lënë pas dore arsyen e ekzistencës së shoqërisë.

Në këto 25 vite ne, motrat Ravasco, i kemi shërbyer popullit shqiptar në mënyra të ndryshme, kemi shpallur Lajmin e Mirë në fshatrat si: Gomsiqe, Korthpulë, Vrith dhe Kaftall, nëpërmjet katekizmit dhe kampeve verore.

Të sapo mbërritura në qytetin e Shkodrës, jemi treguar të gatshme për çfarëdo nevojë, kështu menjëherë jemi njohur dhe kemi vizituar familjet e zonës së “Stacionit të Trenit”, ku tani zhvillojmë aktivitetin tonë në qendrën “Mbretëresha e Paqes” dhe në “Shtëpinë e Mikpritjes” ku mirëpresim vajzat e rrethinave që dëshirojnë të ndjekin studimet në shkollat e qytetit.

“Do të doja tu jap atyre një çati, pak bukë, një përqafim dhe t’ja përcjell Zotit”; të nxitura nga këto fjalë të Nënë Eugenia-s dhe nga nevoja e disa familjeve, në vitin 1998 hedhim hapat e parë të “Shtëpisë Familje”, grupi i parë i të cilës ishte i përbërë nga fëmijë me probleme familjare socialo-ekonomike dhe në vitet pasardhëse duke mirëpritur fëmijët e jetimores së shtetit.



“Të ngrënit, të studiuarit, të pastruarit dhe të luturit sëbashku ka qënë për mua një shkollë jete për një kohë të gjatë. Nëse do të duhej të rijetoja ato vite, patjetër që do të kthehesha tek Ravasco-t.”;

“Gjatë viteve të jetuara në atë shtëpi kam kuptuar që ajo ishte dhe është një shtëpi e dedikuar për edukimin dhe rritjen shpirtërore të vajzave”;

“Në fakt, sa herë kisha nevojë të flisja dhe të shprehja diçka, motrat e mia ishin gjithnjë të gatshme të më dëgjonin, gjithmonë kishin këshillat e duhura në çastin e duhur, gjithmonë kisha një familje ku të mbështetesh”;

“...më kanë mësuar se duhet përfituar nga çdo moment i ditës për të bërë gjëra të mira për veten dhe për të tjerët”;

“... kur jam larguar nga Ravasco valixhja ime ishte e mbushur me bukurinë e jetës së jetuar në bashkësi, me rrugën e fesë së

përshkuar sëbashku, me gëzimin e përbashkët dhe me dritën që drejton te ardhmentime”;

“Ravasco për mua është shkopi që secila hardhi duhet të ketë si mbështetje për tu rritur drejt dhe për të dhënë fryte”;

“Keni qënë ylberi i jetës sonë, na keni dhuruar ngjyrat më të bukura dhe e keni ngjyrosur

atë, gjysma e asaj që jemi në jetë është meritë e juaja”

Këto rreshta të shkruar nga vajzat që kanë jetuar me ne, janë dëshmia më konkrete e përkushtimit që kemi dhënë.

Kemi festuar këtë 25-vjetor duke falenderuar Zotin nëpërmjet Eukaristisë së kremtuar nga Shkëlqesia e Tij Imzot Angelo Massafra e bashkëkremtuar nga disa meshtarë të tjerë në të cilën morë pjesë miq, bashkëpunëtorë, familje, bamirës dhe disa vajza që kanë jetuar me ne.

Ky 25-vjetor shënon një qëllim të realizuar dhe është spiranca që mbështet hapat e së ardhmes, duke na bërë të ndihemi krijesa të vogla në shërbim të Zotit për të mirën e rinisë, po, për dashurën rini!!

KUSHTET E PËRJETSHME TË MOTRAVE “BIJAT E DASHURISË HYJNORE”

E falenderojmë Zotin që gjatë këtij viti të veçantë për ne motrat Bijat e dashurisë Hyjnore, sepse jemi në prag të festës së 100 vjetorit të ekzitimit të Provincës tonë të „Provanisë hyjnore” me qendër në Zagreb, Kongregatës tonë dhe Kishës së gjithëmbarshme iu shtuan me kushtimin e tyre të përjetshëm edhe tre motrat tona: m. Gjystina Kulla, m. Lena Kulla të dyja nga Dioqeza Shkodër- Pult dhe m. Brigita Marku nga Dioqeza e Kosovës.

Me 10 gusht në Katedralën e shën Shtjefnit në Shkodër, gjatë meshës të udhëhequr nga Shkëlqësia e Tij Imzot Angelo Massafra, në bashkëkremtim të shumë meshtarëve, motrat i thanë PO-në e tyre Zotit gjatë ritit të kushtimit përpara eporës provinciale m. Gordana Igrec, duke shprehur kështu

gatishmërinë që prej atij momenti t'i përkasin plotësisht Zotit duke ia dhuruar Atij krejt jetën e tyre. Në mëshën e kushtimit morën pjesë familjarë dhe të afërm të motrave, besimtarë të ardhur nga famullitë ku motrat kanë shërbyr dhe motra të kongregatave të ndryshme.

Edhe një herë me ndjenja gëzimi e falënderojmë Hyjin për këtë dhuratë që na ka bërë, njëkohësisht i lutemi Zotit për thirrje të shenjta në Kongregatën tonë, për thirrje meshtarake dhe rregulltare në popullin tonë dhe në Kishën e gjithëmbarshme.

Zoti i ndihmoftë motrat tona, i bekoftë dhe i udhëheqtë me Shpirtin e vet të Shenjtë!

FORMIMI I MOTRAVE TË REJA NGA SHQIPËRIA DHE KOSOVA

Me datën 22-24 shkurtu takuam në Seminarin Ndërdioqezan – Shkodër, motrat e reja nga kongregatat e ndryshme rregulltare. Një fundjavë ku lëmë të gjitha angazhimet për të qëndruarsë bashku, përtë reflektuar rreth një teme dhe përtë bashkëndarë diçka nga jeta jonë e përditshme. Gjatë këtij takimi na shoqëroi atë Agostino Caletti, sj, me temën: “Dinamikat njerëzore të këshillave ungjillore”. Takimi filloi me një bashkëbisedim mbi njohjen e njëra-tjetrës dhe hyrjen në temë. Gjatë reflektimi mbi këshillat ungjillore, varfërinë, pastërtinë dhe dëgjesën, iu kushtua vëmendje e deçantë dimensionit marrëdhënësor dhe rëndësisë së jetës së përbashkët në jetën e kushtuar. Janë tri këshilla që lidhen ngushtë njëra me tjetrën, si dhe me situatat konkrete të jetës së përditshme.

Gjatë takimit kemi patur një farë kohe jo vetëm për reflektimin personal por edhe bashkëndarje dhe punë të ndryshme në grupe të vogla. Jeta e përbashkët është një mundësi për të bashkëndarë të mirat që Zoti ka vendosur në secilin prej nesh, si dhe një përkrahje që të jetojmë për një mision të përbashkët: të çojmë dashuri aty ku nuk ka dashuri. Kur Atë Agostino foli për kushtin e varfërisë theksoi se të gjithë jemi të varfër përballë tjetrit sepse tjetri ka gjithmonë diçka që unë nuk e kam. Kur flasim për pastërtinë, varfërinë dhe dëgjesën, flasim për pastërtinë, varfërinë dhe dëgjesën e Jezu Krishtit. Ne i jetojmë kushtet vetëm sepse kanë një vlerë para Krishtit dhe për dashurinë e Tij. Pastërtia është thirrja për të dashur me gjithë mendje, me gjithë zemër, me gjithë

forcën dhe me krejt personin tonë, që është i përfshirë në dashuri. Edhe një herë tjetër Atë Agostino na nxiti të rikthehemi te fjalët e Mateut ungjilltar: “Jini, pra të përkryer siç është i përkryer edhe Ati juaj që është në qiell”, dhe na pyeti se në çfarë ishte Zoti i përkryer? Në dashuri! Është një ftesë por edhe një sfidë që të jemi edhe ne të përkryera në dashuri, sepse secili prej nesh ka mundësinë për të dashur, pasi brenda secilit njeri është imazhi i Zotit.

Pas një ditë të frytshme, erdhi edhe bariu i dioqezës sonë, Imzot Angelo Massafra, për Meshë dhe darkë së bashku me ne; në të gjitha takimet e formimit kur ndodhemi në dioqezë, ai është i pranishëm për të dhënë kurajë, për të korrigjuar, për të theksuar rëndësinë e formimit dhe për të kaluar një kohë falas me ne.

Gjatë fundjavës kishim mjaftmomente të gërshetuara sëbashku: formim, lutje, reflektim personal, bashkëndarje, argëtim. Për të gjitha këto gjëra dëshirojmë ta falënderojmë Zotin që na dhuron Vetveten, por edhe na jep mundësinë që nëpërmjet kushtimit tonë të marrim pjesë në dhurimin e Tij, në jetën tonë të përditshme.

Falënderojmë kongregatat tona si dhe përgjegjësete këtyre takimeve, për mundësinë që të rritemi së bashku në dashurinë ndaj Zotit, por edhe ndaj personave që takojmë në jetën e përditshme.

Moter Donika Shpella
Moter Besa Deda

DITA E 1 MAJIT, KUSHTUAR SHËN JOZEFIT PUNTORË “PSE JO NJË DITË E BUKUR SI KJO, SI NJË FAMILJE E VETME!”



Motrat Stigmatine, Madonnina del Grappa, Shoqata e Fizioterapistave dhe Rinia Vullnetare Universitare organizuan: Një ditë për miqtë tanë; *Shtëpi Familja Don Giulio Facibeni, Motrat e NenëTerezës, Projekti Shpresa.* Secili prej nesh të ndryshëm në moshë, status, profesion, prejardhje, besim apo detyrë, portë gjithë me të njëjtën dëshirë që të festojmë së bashku “si një familje e vetme”, Shën Jozefin Puntorë.

Në këtë ditë të veçantë patëm nderin e pranisë së Sh. së Tij Nunci Apostolik Imzot Charles John Brown, i cili udhëheqi celebrimin e Meshës së shenjte, Imzot Angelo Massafra Aqipeshkëv Shkodër-Pult, Famullitari i Katedrales Dom Vlash Palaj, Kustodi i fretërve minor P. Aurel Gjerka, autoritete vendore e Pedagogë të Universitetit të Shkodrës.

Motër Dukata, ia drejtoi fjalimin mikpritës Sh. së Tij, Nuncit Apostolik: “Ardhja juaj e nxiti bashkimin tonë sot e ky është një falenderim i përzëmert ndaj jush që

po e vizitoni Shqipërinë në çdo skaj, famulli dhe në periferi të saj”. Realisht, Shkodra është qyteti i kulturës, i fesë dhe i mikpritjes: Jemi këtu, në Kishën e Motrave Stigmatine, selia e relikëve të së Lumës Maria Tuci, vend i fesë, dijes dhe i kultures e njëjta që u përdor për gjyqje dhe dënime të disa martirëve tanë. Kjo bashkësi ka kënaqësinë të pranojë Zëvendësin e Papës në Shqipëri.

Ndërkohë, Nunci Apostolik, shprehi në omelinë e tij mirënjohje dhe vlerësimin e punës ndaj të gjithë atyre që punojnë për të mirën e personave me aftësi ndryshe. Si shën Jozefi neve ju shërbejmë njerëzve me dinjitet dhe i lindim Kishës bij shpirtëror nën shëmbullin e Marisë Virgjër. Prandaj, nuk duhet të na mungojë kurrë besimi dhe shikimi i fesë ndaj mrekullive që Hyji realizon në jetën tonë të përditshme. Rinia Vullnetare Universitare, treguan gjatë gjithë aktivitetit përkujdesje dhe shërbim të palodhur më gezim e thjeshtësi.

Motrat Stigmatine

MOTRAT E VARFRA TË SHËN KIARËS NË SHKODËR

Ngritja Kanonike e Manastirit të parë në Tokën e Shqipeve

E hënë, 30 shtator 2019



Kremtimi i Eukaristisë Solemne, me dorëzimin e Dekretit të Ngritjes Kanonike Nënës Sonia Giustizieri, Abadeshe e manastirit të Shkodrës, që kulmi i ditës: përreth tryezës së Fjalës dhe të Trupit e Gjakut të Krishtit, u lartësua falënderimi për ecjen e gjatë dhe angazhuese të motrave, që i janë përgjigjur sfidës hyjnore për një prani klarisesh në tokën shqiptare.

Në këtë ditë të ngrohur prej diellit vjeshtor, në qendër të qytetit, kisha e Shkodrës ka jetuar një moment të gjallë hiri. Pranë bashkësisë së motrave Klarise u zhvillua ceremonia solemne për autonominë juridike të Manastirit "Sh. Kjara", gjashtëmbëdhjetë vjet pas fillimit të themelimit nga ana e Manastirit "San Nicolò" të Otrantos (Leçe - Itali).

Në praninë e Shkëlqesisë së Tij Imzot Charles John Broën, Nunc Apostolik në Shqipëri, të Shkëlqesisë së Tij Imzot José Carballo, Sekretar CIVCSVA, të Shkëlqesisë së Tij Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pultit, të Ipeshkvinjve të Shqipërisë, të të nderuarit Atë Aurel Gjerka, Kustod O.F.M. i Shqipërisë, të Nënës Chiara Amata Casalini, Presidente e Federatës së Klariseve të Puljas dhe të një përfaqësie të motrave të Federatës, të Nënës Diana Papa, Abadeshe e manastirit themelues të Otrantos dhe të disa motrave të bashkësisë së Otrantos dhe Leçes, programi i pasur i ditës u zhvillua me shumë përkorë dhe gëzimi vëllazëror që shenjë e bashkimit kishtar.

Gjatë paradites motrat Klarise mirëpritën krejt bashkësinë e motrave Karmelitane të Nënshatit, në dioqezën e afërt të Sapës, për të tatua të gjitha së bashku Imzot Carballo-n: një ngjarje në të cilën jeta monastike femërore, në dy shprehjet karizmatike të pranishme në Shqipëri, u paraqit si shenjë dhe shembull i njësisë nëpërmjet takimit, shkëmbimit, ballafaqimit, ndryshimit. Dashuria e dëftuar dukshëm dhe në mënyrë të ndërsjellë mes dy bashkësive është shenjë shprehëse e gjithë kësaj.

Pasdite, në kishën e manastirit, Imzot Carballo takoi rregulltarët e rregulltare të shumta të dioqezës së Shkodrës dhe të disa dioqezave fqinje, duke u ofruar atyre një reflektim mbi situatën aktuale të Jetës së Kushtuar Zotit, duke i ftuar të gjithë që të mos shkurajohen por ta shohin me fe e shpresë realitetin e sotëm.

Prej tokës së lagur prej gjakut të qindra martirëve, që kanë dhënë jetën për Krishtin mes mureve të po kësaj ndërtese që sot është kthyer në manastir, u ngrit në qiell era e mirë e kemit dhe kënga e lavdit drejt Atij që nxiti guaimi e martirëve, feja e të cilëve mbështetet në Fjalën e një Hyji që shpëton.

Imzot J. Carballo e përfundoi kështu homelinë e vet:

"... Ky manastir në Shkodër është i thirrur, siç lexuam në leximin e parë (Zak 8,1-8), të bëhet "qytet besnik", "mal i shenjtë". Dhe këtu njerëzit, edhe jo katolikë, duhet të gjejnë burimin e ujit të pastër për ta mbushur etjen e tyre me kuptim. Ky vend torture, siç theksonte imzot Massafra në Dekret, ky vend mallkimi – dhe kjo nuk duhet të përsëritet kurrë – do të bëhet vend bekimi, para së gjithash për ju motra, dhe pastaj për të gjithë Kishën dhe për të gjithë burrat e gratë vullnetmirë në Shqipëri.

Zoti jua dhashtë këtë hir, ju bekoftë dhe ju ruajtë në këtë qëllim të shenjtë".



NGA SHOIPËRIA NË AZI SI PELEGRIN TË FESË

Jam shumë e lumtur të ndaj me ju përvojën më të bukur të jetës sime. Mijëra kilometra larg jetova bashkë me shumë të rinj të tjerë katolik një ecje të veçantë drejt rritjes së besimit tonë në Thailand dhe Kambogjia.

Këtë udhëtim e bashkëndava me 8 të rinj të tjerë nga Shqipëria dhe shumë të tjerë nga Luksenburg, Polonia dhe vende të tjera të botës. Plot emocione, prita me padurim të filloj një aventurë të re, ku do të zbuloja kulturën, besimin, natyrën e Azisë, të njihja njerëz të rinj e nëpërmje tyre të zbuloja gjëra të reja rreth vetes dhe rrugës drejt Zotit. Por ky udhëtim nu kishte aq i lehtë, vështirësitë e përshtatjes, ushqimi, klima, ambjenti i ri, njerëzit e ri, pors i krishterë u përpoqa të shoh përtej, të shoh mikëpritjen e ngrohtë të vendasve, përkushtimin e pakursyer të organizatorëve edhe gëzimin në sytë e çdo pelegrini tjetër. Gajtë këtij udhëtimi pata mundësinë të vizitojdhetënjohkulturën, mënyrën e jetës , arkitekturën, besimin e një zone të mrekullueshme të Azisë. Preka nga afër një realitet krejt tjetër që me parë e kisha njohur pak ose aspak. Ishte një kombinim tepër I vecantë mes klimës së lagësht tropikale, shtëpive karakteristike aziatike,veshjes shumëngjyrëshe me motive speciale dhe buzëqeshjes në fytyrën e çdo vendasi.

Përveç anës së bukur të medaljes pata mundësinë të shoh varfërinë e skajshme në të cilën jetonin familje të tëra. Megjithatë jam shumë e lumtur që në sytë e atyre njerëzve pash dëshirën për të dhuruar gjënë më të shtrenjtë që kishin, dashurinë dhe mikpritjen. Ne si pelegrin tëkrishterë kontribuam sado pak ti ndihmonim në jetën e tyre të vështirë, me pak të mira materiale, me dëshirën e madhe për të ndarë kohën tonë me ta dhe sigurisht me lutje.

Askush nuk është aq i varfër sa të mos ketë diçka për të dhënë e askush nuk është aq i pasur sa mos të pranoj çka ti dhurohet. Nga ato familje mora më shumë se dhashë, kuptova se aty jeton Krishti, ajo është jeta e vërtetë.

Në ditët në vazhdim takuam edhe shumë familje e të rinj katolik, në mes të një popullsie me miliona besimtar budist, të cilët jetonin dhe ushtronin besimin e tyre të krishterë me dashurinë e madhe ndaj Zotit. E sigurisht kjo është një ndjesi tepër e veçantë që më lumturon shumë. Pjesa më e bukur e këtij pelegrinazhi për mua ka qenë më e vështira dhe më e lodhshme nga ana fizike,por me ka mbushur shpirtin plot. Ne, 60 të rinjn ga Europa së bashku me shumë të rinjn ga Thailanda në tre ditë ndërtuam një kapelë si dhuratë për Qëndrën e Jezuitëve të studimit Xavier. Në përfundim të ndërtimeve celebruam Meshën e parë në këtë kapelë. Ishte ndjesia më e bukur në botë, që ti së bashku me miqtë e tu, të cilët deri para disa ditëve as që i njihje, ke kontribuar në ndërtimin e shtëpisë së Zotit, ku shumë besimtar do të shkojnë të luten e të takojnë Jezu Krishtin.

Tani që kthehem e kujtoj këtë eksperiencë, di të them se kam jetuar ditët më të bukur atë jetës sime, kam jetuar mes emocioneve dhe ndjesive të mrekullueshme të papërjetuara më parë, jam ndjerë e bekuardheshumë e lumtur. Por mbi të gjitha jam ndjerë më afër Krishtit. Të dashur të rinj dhe bashkëmoshatar të mi, nëse doni të jetoni në Krishtin, mos kini frikë ta kërkon i. E nëse vërtetë besoni në të, Ai do të bejë çdogjë përju. “Jezusi e pyeti: “Çka dëshiron të bëj për ty?” Rabbuni! Që të shoh- përgjigji i verbëri. Jezusi tha: “ Shko lirisht! Feja jote të shpëtoi” dhe atypëraty pa e u vu të udhëtojë

GO4PEACE
NJË MUNDËSI PËR TË JETUAR MES TË RINJVE
TË UDHEHEQUR NGA FJALA E ZOTIT

Dëshiroj të nis këtë rrëfim me pyetjen “Çfarë është “Go4peace” (“Shkojmë për paqe”)? “Go4peace” për herë të parë “Go4peace” u organizua në verën e vitit 1996, ku një grup të rinjsh gjermanë, nën drejtimin e priftit Meinolf Wacker udhëtuan drejt Bosnjës së shkatërruar pas luftës, dhe ndihmuan sado pak që mes rrënojave të rindërtohej qyteti i Vidovicës. Për 18 vite rradhazi ky organizim u bë në Bosnje. Gjatë këtyre viteve u shtuan të rinj edhe nga shtete të tjera, shtete nga gjithë Europa. Mëtej, kampi “Go4peace” vijoi të zhvillohej ne shtete te ndryshme. Pata fatin te marr pjesë për herë të parë në kampin “Go4peace” në vitin 2017, kur ky kamp u zhvillua në Shkodër. Kë të vit, në Brno të Reoublikës Çeke, mora pjesë për të tretën herë radhazi, dhe banova për dhjetë ditë si 120 të rinjn ga 12 shtete të Europës. Është gjithmonë një përvojë fantastike të jetuarit cdo ditë me të rinj nga vende të ndryshme të Europës, realizimi së bashku I punëve te ndryshme vullnetare duke ndjekur ditë pas dite një moto të ndryshme, e cila lidhet me ungjillin e ditës. Megjithatë, këtë vit do të përjetoja një eksperiencë më ndryshe nga herët e kaluara, pasi më ishte caktuar detyra për të folur rreth regjimit komunist në Shqipëri. Ishte një privilegj I madh, mirë po vinte me një barrë të madhe, pasi nuk është aspak e lehtë te përshkuhet ajo periudhe aq e errët për popullinshqiptar e për Kishën Katolike. Megjithatë mendoj qe ia dola mjaft mirë në përshkrimin e vuajtjeve gjatë peiudhës së komunizmit. Përveç disa kërtimeve të bëra, dy ishin ndihmat që kisha në realizimin e këtij prezantimi:

1. Familja ime që herë pas here, që kur isha I vogël, më ka treguar për aspekte të ndryshme të komunizmit.
2. Kisha Katolike e cila duhet falenderuar përkujdesin që tregon nëinformimin e brezave të rinj rreth vuajtjeve të kaluara gjatë atyre viteve të gjata për popoullin tonë.

Ishte emocionuese për mua të shikoja se si te rinjtë europeanë në fillim ishin plot habi e më pas iu rënqethej mishi e sytë iu mbusheshin me lot, ndërsa dëgjonin histori rreth internimeve e

torturave të ndryshme te asaj periudhe. E pra, ky është një aspekt i rëndësishemi “Go4peace”, pasi persona nga vende të ndryshme, që pake aspak e njihen, mësojnë të vërteta të tilla tronditëse për ta. Kam dëshirë të ndaj me ju edhe dicka që me prek gjithmonë ne këtë kamp rinor. Çdo ditë gjatë kampit, bëhet kremtimi I Meshës Shenjte dhe momenti i lutjes AtiYnë, është dicka tejet e vecantë për mua. Të rinj nga vende të ndryshme, të kapur dorë për dore, që luten në gjuhën e tyre njëzëri: e si mund ta lumturojmë më shumë Zotin, sesa me këtë unitet të tillë, që e manifestojmë edhe gjatë punëve të ndryshme vullnetare që i realizojmë në grupe me kombësi të përziera.

Motoja në foto: Së bashku –e si mund të jetë më mire?

Nuk mund të lë pa përmendur dhe grupin shqiptar, që njihej nga të gjithë si shume aktiv, pasi jepte shumë energji positive gjithandej. I formuar nga këngëtarë, kërcimtarë e animatorë, i vinte të gjithë në lëvizje gjatë kohës së lirë. Eventi final i “Go4peace” u realizua në kalanë e qytetit Brno, ku te rinjë përgatitën ushqim për të pastrehët dhe të gjithë kërcyen nën tingujt e muzikës shqiptare, që këndohej nga pjesëtarë të grupit tonë.



MISIONI NË THETH DHE BREG LUMIT

Në muajin korrik u zhvillua misioni në malet e famullisë së Shalës në Dukagjin. Misioni ka zgjatur 15 ditë, filloi me 21 korrik dhe mbaroi me 5 gusht. Misioni u drejtua nga famullitari i At Aurel Gjerkaç ofm, bashkëpunuan në këtë mision fra Jak Kolgjeraç ofm, motër Diljana dhe motër Veroniketë Kongregatës së motrave misionare të Jezusit Fëmijë. Misioni filloi me bekimin eshtëpive nëpër të gjitha zonat e këtyre vendeve duke filluar nga Gimaj, Nënmaçiq, Breg Lumi, Lotaj, Abat, Lekajt dhe gjithë zonën e Thethit. Ku dhe patëm prej besimtarëve një mikpritje vërtet bujare siç e lyp tradita shqiptare. Katekizmi për ata që përgatiteshin për të marrë sakramentet e shenjta. u zhvillua çdo pasdite. Në ditët e fundit të misionit patëm në vizitë baritore arqipeshkvin tonë shkëlqesinë e tij imzot Angelo Massafra, ku

dhe e falënderojmë për zemërsisht për vizitën e tij baritore në këtë mision. Vizita baritore u zhvillua kështu: Me 3 gusht, dita parë e vizitës, në orën 11:00 u kremtua Mesha nga arqipeshkëvi në Theth. Ku patëm pagëzime, krezmime dhe kurora martese. Dhe pas kësaj monsinjori pati një takim me besimtarët, ku u trajtuan çështjet e ndryshme. Me 4 gusht dita e dytë arqipeshkëvi kremtoi Meshën në ora 11:00 në Gimaj, po ashtu u takua me besimtarët pas meshe, ku u biseduapër restaurimin e kishës në Gimaj. Pas dite në orën 4 arqipeshkëvi kremtoi meshën në Abat ku dhe pati pagëzime krezmime dhe kurora martese. Pas meshe ishte edhe një takim me besimtarët e Abatit e Pecajve, Nicajve dhe Lekajve. Me 5 gusht dita e tretë arqipeshkëvi kremtoi Meshën në Breg Lumi ku dhe pati pagëzime krezmime dhe kurora Martese. Dhe pas meshe takimi me besimtarët e vendit.

KAMPI VEROR ME FËMIJËT E KISHËS SË SHËN KOLLIT

Nga data 24 deri me datën 28 qershor u zhvillua kampi veror me fëmijët e lagjes Rus katolik, Skënderbeg, Mahalla e re, Partizani, ish dega ushtarake etj, në qytetin e Shkodrës. Ky kam veror u mundësua nga një bashkëpunim midis përgjegjësit baritor në Kishën e shën Nikollit në Shkodër, në bashkëpunim me motrat Franceskane Misionare të Zemrës së Krishtit dhe motrat Vinçenciane. Kampi veror u zhvillua në ambientet e motrave Vinçensiane, ku kishte një hapësirë të mjaftueshme dhe pozicion favorizues, pothuajse qendra e lagjeve. Kjo zonë ka një numër të madh fëmijësh, dhe frekuentimi në këtë kamp ishte shumë i madh. Gjatë paradites e kemi zhvilluar kampin me fëmijët e shkollës nëntëvjeçare nga ora 9 deri në orën 12. Ndërsa mbasdite nga ora 16 deri në orën 19 kanë marrë pjesë të rinjtë e shkollave të mesme. Tema e kampi ishte "lini fëmijët të vijnë tek un se atyre ju përket Mbretëria e qiellit". Çdo ditë njëri prej përgjegjësve në fillim të ditës ka trajtuar një temë të ungjillit, duke ju lënë në fund disa pyetje si bashkëndamje në grup. Mbas bashkëndamjes ka pasur punë laborator në grupe të ndryshme, dhe e kemi mbyllur aktivitetin me lojëra të përgatitura nga animatorët.

Ndërsa me adoleshentët kemi parë disa nga figurat e Martirëve tonë Shqiptarë, duke filluar nga i lumi Mark Çuni, e lumja Marie Tuci, i lumi dom Mikel Beltoja dhe i lumi Gjellosh Lulashi. Nga historia e këtyre martirëve kemi mësuar disa nga vlerat dhe virtytet e të krishterit. Prejardhja e tyre nga familje të shëndosha në vlerat e moralit dhe në praktiken e fesë, na kanë transmetuar edhe neve vlerën e lutjes dhe të besimit sepse ka qenë kjo forcë që ato i ka shoqëruar në çdo moment të jetës së tyre. Ato kanë qenë edhe për ne sot dëshmi konkrete se si ne të rinjtë duhet të jetojmë besimin tonë në shoqërinë të cilës i përkasim. Të mos kemi frikë dhe të jemi të guximshëm me dëshmuar që i përkasim Krishtit. Edhe një herë ne fund kam dëshirë të falënderoj të gjithë ato që kanë bashkëpunuar në realizimin e këtij aktiviteti, animatorët për gadishmërin e tyre dhe për mundin që kanë dhënë pa u kursyer aspak. Shumë për zemërsisht falënderoj motrat për bashkëpunimin dhe për kontributin që kanë dhënë në mbarëvajtjen e këtyre ditëve, duke ju dhënë sadopak gëzim fëmije që kanë marrë pjesë në këtë kamp veror.

dom Kristjan Marku

KAMPI VEROR NE SHKREL

Nën kujdesin e famullitarit dom Nikolin Toma dhe të grupit të animatorve kampi Veror 2019 këtu në Shkrel ishte një ndër organizimet më të bukura që zhvilloi famullia jonë. Të gjithë fëmijët ishin të lumtur nën atmosferën e shumë lojrave apo kërcimeve që animatorët iu ofronin. Fëmijët ishin të ndarë në 4 grupe, ku secili grup kishte mundësinë dhe dëshirën për të dhënë më të mirën e mundshme. Projektet që zhvilloheshin nëpërmjet ideve të shumëllojshme të fëmijëve e bënin shumë të vështirë zgjedhjen e një fituesi. E me patjetër pjesë e këtij kampi do të ishin edhe eskursionet e ndryshme ku secili fëmijë i priste me nxitim. E nuk duhet të harrojmë të përmendim të papriturat që na trokisnin çdo ditë në derë. E tillë ishte dhe surpriza e ardhjes së një grupi italian duke ia shtuar atmosferën kampit tonë. Ndërsa ditët kalonin dhe ne aspak s'po e kuptonim, kampit tonë nisi ti vinte fundi. Por pas pak ditësh një grup fëmijësh u përball me emocione shumë të forta, siç ishin ato të krezmimit. Të lumtur dhe të mbërthyer nga emocioni secilit nga ne i mbizotëronte një buzëqeshje në fytyrë, mund të them buzëqeshja e jetës, sepse momentet e marrjes së shpirtit shejtë janë të pashterueshme. E pak ditë më vonë të përzgjedhurit si animator dolën për një tjetër eskursion në Theth duke shijuar koncertin që po zhvillohej atje. E dalja në malin e Veleçikut ishte përsëri një tjetër eksperience e paharrueshme për ne. Kontakti me natyrën të jepte një emocion të

veçantë. Bukuria natyrore që Zoti i ka falë këtij vendi nuk mund të pershkruhet përveçse të përjetohet. Gjellbërimi, ajri i pastër, pamja mbreslënëse mund të tejkalojë çdo hamendësim tonin. Jashtëzakonisht e lumtur nga një vizitë e tillë i dhamë fund një eksperience tjetër. Por duke dashur të zbulojmë dhe të gërmojmë në mënyrë mision të ri rreth Dom Nikollë Gazulli. Me dëshirën e zjarre për të gjetur gjurmë nga jeta e tij në mënyrë të pyesnim të moshuarit në vendin tonë. E duke bërë lidhjen mes intervistave të shumta gjetëm shpellen ku ka qëndruar 15 muaj të jetës së tij. Shpella gjendej në afërsi të fshatit Vrihtë, tek vendi i cili quhet ndryshe "Gropat e Thive". Duke përshkruar një ambient të tillë, e duke prekur nga afër shpellen ku ka qëndruar u mahnitëm nga historia që e rrethonte vendin tonë. Duke gërmuar në brendësi u gjenden mjete elementare për mbijetesë, si dhe krevati i tij. E si dëshmi për jetesën në një vend të tillë gjetëm thengjilla, ku është bërë zjarri. E pra këtu në Shkrel stina e Verës nuk kishte si të mbyllej ndryshe, përveçse me të gjitha ngjyrat e ylberit dhe duke u përballur me atmosfera nga më emocionueset, e pse jo tanimë duke iu ofruar edhe ju të dashur lexues të bëheni dëshmitar të organizimeve tona duke ju ftuar që të na vini dhe vizitoni ambientet e famullis tonë në malesi.

Kroniste nga Shkreli
Sonila Milaj

KAMPI VEROR NË KRAJEN

Është krijuar si traditë tashmë që në dioqezën e Sapës, shumë famulli gjatë kësaj periudhe të nxehtë vere, të kenë prioritet edhe organizimet kampeve verore, duke iu dhënë njëmundësi më shumë fëmijëve dhe të rinjve për t'u zbavitur dhe për t'u edukuar mbi të gjitha. Një ndër to është edhe shoqata "Ambasadorët e Paqes" në bashkëpunim me Misionin Katolik – Blinisht të Zadrimës, që edhe këtë vit kanë organizuar kampin veror për moshat nga klasa e 6 deri në klasën e 10.

Është ndër kampet më të mëdha të dioqezës, i cili zhvillohet në Krajen të Zadrimës, pranë shkollës At Giovanni Fausti dhe ka një pjesëmarrje të madhe me rreth 80 të rinjë në javë.

Tema e këtij viti ka qenë "Priji njëri-tjetrit duke nderuar shokun më parë e më tepër" (Rom 12, 10).

Ky kamp ka filluar me datën 1 korrik dhe do të përfundojë me datën 30 korrik 2019, një periudhë kohore kjo e cila ju jep mundësinë shumë personave të marrin pjesë. Pjesëmarrësit janë jo vetëm nga Dioqeza e Sapës, por edhe nga dioqezat e tjera si Shkodra, Lezha, Tirana, Durrësi dhe



Prishtina.

Nën kujdësin e famullitarit Dom Enzo Zago, motër Arta Suli dhe 20 animatorëve, i gjithë kampi ka patur një zhvillim mjaft të suksesshëm ku është përqafuar me shumë dashuri çdo moment që kanë bashkëndarë së bashku të gjithë fëmijët dhe të rinjtë sipas grupmoshave të ndryshme. Çdo ditë ka patur organizimin dhe të

veçantën e saj, ku janë trajtuar mjaft tema të ndryshme biblike dhe sociale, si dhe lojëra dhe aktivitete të tjera me tematika të përshtatshme sipas moshave pjesëmarrëse, duke i lënë vend secilit person të jetë sa më aktiviv e të shpalosë dhuratat që Zoti i ka dhënë për t'i bashkëndarë me të tjerët.

Kampi veror është vizituar edhe nga Ipeshkvi i vendit Imzot Simon Kulli, i cili ka falenderuar të gjithë organizatorët dhe

pjesëmarrësit që i bashkohen këtyre eventeve që japin fryte paqeje dhe dashurie për të rinjtë tanë që janë e ardhmja e Kishës dhe e vendit.

Violeta Marashi

"TË PAGËZUAR DHE TË DËRGUAR" MISIONI VEROR 2019

Dioqeza e Sapës që nga viti 2000 e deri në ditët e sotme, organizon misionet verore në zonat malore të Pukës, Fushë Arrësit dhe Tropojës. Nisur nga kjo traditë e lindur nga ish ipeshkvi i kësaj dioqeze, Imzot Dodë Gjergji dhe vazhduar edhe nga ipeshkvinjtë pasardhës, Imzot Lucjan Avgustini dhe Imzot Simon Kulli, ky mision ka marrë përmasa të gjera duke realizuar kështu veprën ungjillëzuese ashtu sikur nga mëson vetë Jezu Krishti.

Edhe këtë vit, që nga data 20 qershor ka filluar misioni i radhës dhe ka vazhduar edhe gjatë gjithë muajit korrik, ku kanë marrë pjesë grupe të ndryshme të përbërë nga Meshtarët, motrat, katekistët dhe laikë vullnetmirë që ofrohen lirisht për të marrë pjesë në këtë organizim dioqezan. Vlen të përmendim faktin se brenda radhëve të misionarëve kanë ardhur edhe seminaristë nga Italia, të cilët kanë dashur të jenë pjesë e këtij misioni, duke kaluar kështu një eksperiencë të mrekullueshme shpirtërore në këto vende.

Me dëshirën e ipeshkvit të vendit, Imzot Simon Kulli, këtë vit tema e misionit ishte "Të pagëzuar dhe të dërguar", një temë kjo e Atit të Shenjtë zgjedhur për muajin misionar të tetorit të ardhshëm. Dhe me këtë moto rreth 45 misionarëtë ndarë në 10 grupe të ndryshme, kanë zhvilluar misionin e tyre në çdo fshat, pa marrë parasysh kushtet gjeografike ku terreni është mjaft i thyeshëm, pa marrë



parasysh vëshirësitë e vapës dhe të largësisë së fshatrave nga njëri-tjetri, por ashtu me besimin në Zot ia kanë dalë të jenë afër besimtarëve më të largët.

Gjatë misionit ato kanë kremtuar meshën Shenjte, kanë zhvilluar takimet e katekizmit me të rinjtë dhe me fëmijët, pa harruar edhe lojërat e ndryshme. Gjithashtu një rëndësi e veçantë iu është kushtuar bekimittë familjeve, vizita tek të sëmurëtsi dhe

sakramenteve të shenjta si rrëfimit, kungimit dhe krezmimit. Është një shenjë e mirë bashkimi dhe bashkëpunimi kjo, ku tregon se bijtë e Zotit janë të gjithë njësoj dhe kisha nënë është në kujdes të tyre në çdo kohë dhe në çdo vend.

Qendrat mikpritëse të misionit kanë qenë, Famullia e "Shën Jozefi" Fushës -Arrës, pranë motrave të kësaj famullie, famullia "Shën Gjergji" në Iballë të Pukës, Famullia

"Zoja Rruzare në Gjegjan si dhe Motrat Françeskane të Zemrës së Krishtit në Dushaj-Tropojë.

Të gjithë grupet e misioneve janë vizituar edhe nga Bariu i Sapës, Imzot Simon Kulli, i cili përveç se ka shpërnda edhe Sakramentin e Krezmimit tek të rinjtë, ka shprehur edhe mirënjohjen dhe falenderimin e tij të veçantë për çdo misionar, që është treguar i gatshëm për të lënë çdo anagazhim të tij, duke ardhur në këto zona dhe duke ungjillëzuar dhe dëshmuar fenë dhe besimin e Zotit!

Violeta Marashi

SHTEGTIMI I SHQIPTARËVE NË GJENACAN

Të dielën, më 26 maj 2019, shqiptarë të ardhur nga bashkësi të ndryshme emigrantësh të shpërndarë në mbarë Italinë dhe prej Shqipërisë edhe këtë vit kanë dashur t'i thurin lavde Zojës së Këshillit të Mirë në Gjenacano (Romë, ITALI), Pajtores të Shqipërisë.

Migrantes-i i Konferencës Ipeshkvnore Italiane, që prej 18 vjetësh organizon këtë ngjarje, ka mundur të regjistrojë gjatë këtij viti një pjesëmarrje në rritje si në numër, ashtu edhe në një pjekuri më të madh fetare, duke qenë se grupet, të shumtë në numër, janë më të organizuar dhe më të rregullt, duke dëshmuar kështu një frekuentim më të madh në bashkësitë përkatëse dhe një integrim më të madh në ecjen shpirtërore të famullive. Në fytyrat e tyre të qeshura dhe në numrin e madh të fëmijëve vihej re një gëzim familjar falë një përfshirjeje në shoqërinë e re ku jetojnë. Emocioni për të takuar me këtë rast bashkëkombas të tjerë ka nxitur krijimin e një klime lutjeje falënderimi dhe kërkesë mbrojtjeje nga Virgjëra Mari si qendra dhe pika e bashkimit të të gjithë shqiptarëve të shpërndarë nëpër botë.

Me gjithë shiun e shumë dhe klimën vjeshtore është zhvilluar procesioni i gjatë nëpër rrugët e qytetit gjatë të cilit besimtarët vazhdimisht kanë kënduar fjalët e këngës "Kthehu, o Zoja e Këshillit të Mirë"; "Kthehu" – thotë kënga– për të shoqëruar bijtë e tu nëpër rrugët e botës ju janë shpërndarë", me shpresën që, shtojmë ne, shqiptarët e emigruar në të gjithë botën të jenë një popull i vetëm, që nderon tokën e vet dhe që provon ndjenjën e bashkimit. Kremtimi eukaristik është udhëhequr prej Shkëlqesisë së tij G. Frendo, ipeshkëv i Tiranë-Durrësit dhe President i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare dhe si bashkëkremtues ishte i pranishëm edhe Imzot A. Massafra,

Arqipeshkëv Metropolit Shkodër-Pult, së bashku me tetë meshtarë të tjerë, si edhe me Imzot P. Feliccolo-n, drejtor i Zyrës *Migrantes* i Dioqezës së Romës. Në homelinë e tij ipeshkvi ka theksuar se nëse i besojmë Shpirtit Shenjt, dhuruar prej Zotit atij që beson në Të, atëherë ky besim do të jetë rruga që do ta na çojë drejt bashkimit;

pra, ftesa e ipeshkvit synonte nevojën për të ruajtur bashkimin dhe vëllazërinë edhe në tokën e re ku ata kanë emigruar; gjithashtu, një lutje e veçantë është bërë për situatën aktuale politike në Shqipëri, duke shpresuar në një reformë në drejtësi, që të luftojë korrupsionin dhe të nxisë të mirën e përbashkët.

Në përfundim të kremimit, një poeteshë shkodrane i ka recituar Virgjërës Mari disa rreshta prekës, që kanë ngjallur emocion tek të gjithë të pranishmit; këto rreshta flisnin për jetën e përditshme të besimtarëve, shpesh të lënë pas dore dhe të harruar, që vetëm me fe dhe nën mbrojtjen e Virgjërës Mari mund të gjenin ngushëllim. Këtë vit, në përfundim të ceremonisë, është paraqitur edhe Koordinatori i ri kombëtar i baritores për emigrantët shqiptarë në Itali në personin e meshtarit të ri shqiptar Dom Elia Matija, i inkardnuar në dioqezën e Pistojes, të cilit të gjithë të pranishmit i kanë uruar punë të mbarë. Kushtet klimaterike, për fat të keq, nuk kanë bërë të mundur organizimin e drekës në oborrin e

Bashkisë dhe pjesëmarrësit, të shoqëruar prej buzëqeshjes bekuese të Zojës së Këshillit të Mirë, janë kthyer në shtëpitë e tyre me urimin e dëshirën për ta përsëritur përvojën e mrekullueshme të lutjes vitin e ardhshëm me sigurinë se do ta kenë gjithmonë Marinë si mbrojtëse dhe pajtores të familjeve të tyre.

Dom Pasquale Ferraro



Ditën e shtunë
21 Tetor 2017 në orën 10.00
në Katedralen
«Shën Shtjefni»
Shkodër

Mesha e parë të dielën
22 tetor ora 10.30
Famullia e «Zojës Ruzare»
Bardhaj

Vepra e Vogël e Provanisë Hyjnore
shpall me gëzim

Shugurimin
Meshtarak
të
Dom Pavlin Preka
Nëpunjet shtrirjes së duarve
dhe lutjes shuguruese të
Mons. Angelo Massafra



Për shëlbim meshtaria dom Pavlin!

Redaksia



facebook

HAPËSIRË MEDIATIKE

Regjistrohu në kanalin tone!

NgjarjetKishaKatolikeShkoderPult

Do të gjeshe video të ngjarjeve
më të rëndësishme të dioqezës



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Dom Gjovalin Sukaj

Lektore
Emanuela Marku Matija

Faqosja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Fiorentina"